GOSNISHTI
AUDITORS & PARTNERS ®

---

**Ligji 66/2020 date 21.05.2020**

**PËR TREGJET FINANCIARE TË BAZUARA NË**
**TEKNOLOGJINË E REGJISTRAVE TË SHPËRNDARË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
**Objekti i ligjit**

Objekti i këtij ligji është rregullimi i emetimit të tokenëve digjitalë dhe/ose të monedhave virtuale, i licencimit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e shpërndarjes, tregtimit e ruajtjes së tokenëve digjitalë dhe/ose monedhave virtuale, i agjentit të tokenëve digjitalë, ofruesit të shërbimeve inovative dhe sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive.

Neni 2
**Fusha e zbatimit**

Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimtaritë e rregulluara dhe subjektet, që ushtrojnë veprimtari sipas këtij ligji, në ose nga territori i Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
**Përkufizimet**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Fondi i investimeve alternative" ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për sipërmarrjet e investimeve kolektive.
2. "Subjekt kërkues" është çdo person juridik që plotëson një aplikim për licencë ose për marrjen e një autorizimi lidhur me prospektin e plotë/ aktofertën/relacionin prezantues të një STO-je ose ICO-je/ose një certifikim tjetër sipas këtij ligji.
3. "Autorizimi" është miratimi i dhënë nga AMF-ja për prospektin e plotë/aktofertën ose relacionin prezantues të një STO-je apo ICO-je, në përputhje me kreun IV të këtij ligji.
4. "Sipërmarrje e automatizuar e investimeve kolektive DT" është çdo person juridik ose bashkim asetesh që administrohet nga një subjekt i licencuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sipërmarrjet e investimeve kolektive dhe i licencuar si sipërmarrje e automatizuar e investimeve kolektive DT, në përputhje me këtë ligj. Kuotat e sipërmarrjes së investimeve kolektive të automatizuara DT përfaqësohen nga token digjital dhe/ose monedha virtuale. Sipërmarrjet e automatizuara të investimeve kolektive DT investojnë

ekskluzivisht në token digjital ose monedha virtuale, duke mundësuar përdorimin e kontratave të zgjuara, ose marrëveshje të tjera të teknologjisë inovative, nëpërmjet integrimit të një sistemi të automatizuar robotik të konsulencës, i cili vepron si këshillues investimesh dhe/ose si një shoqëri administruese e fondeve.

5. "Licenca e sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive DT" është licenca e lëshuar nga AKSHI për një sipërmarrje të automatizuar të investimeve kolektive DT, në përputhje me këtë ligj.

6. "Këshilli i administrimit/këshilli mbikëqyrës" është organi vendimmarrës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

7. "Dita e punës" ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore.

8. "Bursë e centralizuar DLT" është bursë që përdor teknologjinë DLT, ku çelësi privat për aksesimin e tokenëve digjitalë dhe/ose monedhave virtuale, që tregtohen në këtë bursë, mbahet nga vetë bursa DLT.

9. "Ambient tregtimi i centralizuar DLT" është ambienti i tregtimit që përdor teknologjinë DLT, ku çelësi privat për aksesimin e tokenëve digjitalë dhe/apo monedhave virtuale që tregtohen në këtë ambient tregtimi mbahet nga vetë ambienti i tregtimit.

10. "Certifikimi" është certifikimi i dhënë nga AKSHI, në përputhje me këtë ligj.

11. "Pjesëmarrja influencuese" është pjesëmarrja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë në kapitalin e një personi juridik:

a) 10% ose më shumë të kapitalit ose të të drejtave të votës, duke mbajtur parasysh agregimin; ose

b) që jep mundësi të ushtrohet influencë e konsiderueshme mbi administrimin e personit juridik, ku mbahet kjo pjesëmarrje.

12. "Autoritetet përgjegjëse" janë Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

"Autoriteti përgjegjës" është një nga dy autoritetet kompetente, rast pas rasti, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

13. "Konflikti i interesave" ka të njëjtin kuptim me përcaktimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

14. "Kujdestar" është ofruesi i shërbimit të ruajtjes, mbajtjes dhe/ose shërbimeve administrative të llogarive të titujve në emër dhe për llogari të personave fizikë dhe juridikë.

15. "Portofoli i kujdestarit" është portofoli digjital, në të cilin çelësi privat për të aksesuar tokenët digjitalë dhe/ose monedhat virtuale mbahet nga një palë e tretë që ofron shërbimin e kujdestarisë së portofolave virtualë, për emër dhe llogari të zotëruesit të tokenit/ëve digjitalë dhe/ose monedhave virtuale.

16. "Bursë e decentralizuar DLT" është bursë, e cila përdor teknologjinë DLT, ku çelësi privat për të aksesuar tokenin/ët digjitalë dhe/ose monedhat virtuale, të cilat janë subjekt i transaksioneve në këtë bursë, mbahet nga vetë përdoruesit e bursës.

17. "Ambient tregtimi i decentralizuar DLT" është një ambient tregtimi që përdor teknologjinë DLT, ku çelësi privat për të aksesuar tokenët digjitalë dhe/ose monedhat virtuale, të cilat janë subjekt i transaksioneve në këtë ambient, mbahet direkt nga përdoruesi i sistemit të këtij ambienti tregtimi DLT.

18. "Deklarata e përputhshmërisë së marrëveshjes teknologjike inovative" është deklarata e përgatitur dhe e nënshkruar nga ofruesi i shërbimit inovativ, nëpërmjet së cilës ky i fundit deklaron se marrëveshja e inovacionit teknologjik përmbush të gjitha kushtet, kriteret e detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.

19. "Deklarata e emetuesit mbi përputhshmërinë" është deklarata e përgatitur dhe e nënshkruar nga agjenti DT, nëpërmjet së cilës ky i fundit deklaron se emetuesi përmbush të gjitha kushtet, kriteret e detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.

20. "Deklarata e përputhshmërisë së titullarit të licencës" është deklarata e përgatitur dhe e nënshkruar nga agjenti TD, i cili, në përputhje me nenin 17, të këtij ligji, deklaron se titullari i licencës përmbush të gjitha kushtet, kriteret e detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.

21. "Tokeni digjital i aseteve" është çdo token digjital, i cili nuk përfshihet në asnjë prej kategorive të mëposhtme:

i. token digjital i pagesave;
ii. token digjital i titujve;
iii. token digjital shërbimesh.

22. "Tokeni digjital i pagesave" është çdo token digjital, i cili përdoret si mjet shkëmbimi, instrument pagesash, njësi llogaritjeje ose rezervë vlere dhe që nuk përfshihet me asnjë nga kategoritë e mëposhtme:

i. token digjital i titujve; dhe
ii. token digjital shërbimesh.

23. Tokeni digjital i titujve" nënkupton përfaqësime digjitale të vlerës, të ngjashme me titujt e tjerë të përcaktuar, sipas legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, që bazohen në teknologjinë *block- chain*, të konfirmuar nga një autoritet kompetent kombëtar, kur plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) ato janë lirisht të transferueshme;

b) ato i japin pronarit disa të drejta monetare ose të drejta pronësie mbi projektin, ose nëse ajo ka karakteristika të ndarjes së fitimit, ose një të drejtë të paracaktuar, ose ata japin pushtetin vendimtar për pronarin në projektin e emetuesit.

Çdo token digjital, që kombinon karakteristikat e tokenit digjital të titujve me një ose më shumë kategori të tjera të tokenëve digjitalë, do të konsiderohet si token digjital i titujve, në kuptim të këtij ligji

24. "Tokeni digjital" është shenjues digjital, i cili:

1) është thelbësisht i varur prej teknologjisë DLT; dhe

2) përfshihet ekskluzivisht në një nga kategoritë e tokenëve digjitalë të listuar më poshtë:

a) token digjital i pagesave;

b) token digjital i titujve;

c) token digjital i shërbimeve;

ç) token digjital i aseteve.

25. "Tokeni digjital i shërbimeve" është token digjital, i cili:

a) mundëson aksesin në një aplikacion, shërbim apo mall; dhe

b) nuk ofron asnjë vlerë, shërbim apo aplikueshmëri jashtë platformës DLT, në të cilën është emetuar.

26. "DLT" ose "Teknologjia e regjistrit të shpërndarë" është bazë e decentralizuar e të dhënave, në të cilën informacioni dhe/ose të dhënat regjistrohen në mënyrë të sigurt, verifikohen në mënyrë konsensuale dhe shpërndahen në mënyrë të sinkronizuar nëpërmjet një rrjeti të shumëfishtë nyjash ose mjeteve të tjera teknike, në përputhje me përkufizimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative dhe ku të gjitha kopjet e bazës së shpërndarë të të dhënave konsiderohen origjinale.

27. "Bursë DLT" është bursë e centralizuar ose e decentralizuar DLT, në të cilën:

a) mund të listohen e tregtohen tokenë digjitalë të shërbimeve, tokenë digjitalë të pagesave dhe tokenë digjitalë të aseteve; dhe

b) krahas aktiviteteve të listuara në shkronjën "a", mund të kryhen edhe këmbime ndërmjet parasë FIAT dhe/ose monedhave virtuale kundrejt tokenëve digjitalë të shërbimeve, tokenëve digjitalë të pagesave, tokenëve digjitalë të aseteve dhe anasjelltas; dhe

c) krahas aktiviteteve të listuara në shkronjat "a" dhe "b", mund të listohen e tregtohen ose të kryhen këmbime ndërmjet tokenëve të titujve virtualë dhe e cila zotëron një licencë për bursë DLT nga AMF-ja dhe nga AKSHI, në përputhje me këtë ligj.

28. "Licencë e bursës DLT" është licenca e lëshuar nga AMF-ja dhe AKSHI si bursë DLT, në përputhje me këtë ligj.

29. "Platforma DLT" është çdo platformë apo strukturë, e ndryshme nga ajo e një burse DLT, ku emetohen ose përdoren tokenë digjitalë dhe nëpërmjet të cilave:

a) mundësohet aksesi në aplikacione, mallra dhe shërbime të ndryshme; dhe/ose

b) mundësohet shlyerja në fonde e tokenëve digjitalë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga emetuesi i tyre.

30. "Ambient i tregtimit DLT" është ambienti i tregtimit, ku kryhet aktiviteti tregtar i një burse DLT, sipas certifikatës së dhënë nga AKSHI pas vlerësimit të kritereve të përcaktuara nështkronjat "a", "b", "c", "ç" e "d", të nenit 51, të këtij ligji. Ambient i tregtimit DLT do të konsiderohet qoftë një ambient tregtimi i centralizuar, ashtu dhe një ambient tregtimi i decentralizuar.

31. "Agjenti i tokenit digjital (TD)" është personi juridik që posedon një licencë agjenti TD të lëshuar në përputhje me këtë ligj.

32. "Licencë agjenti TD" është licenca e lëshuar për një agjent TD në përputhje me këtë ligj.

33. "Prospekti i sipërmarrjes së investimeve kolektive DT" është dokumenti i shkruar që përcakton termat e ofertës së një "sipërmarrjeje të investimeve kolektive".

34. "Para elektronike" ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për bankat.

35. "Para FIAT" është mjet financiare në formën e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike, vendase ose të huaja, të cilat kanë kurs ligjor.

36. "I aftë dhe i përshtatshëm" ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit. Në kuptim të këtij përkufizimi, kërkesat për aftësi e përshtatshmëri duhet të plotësohen nga:

i. çdo aksionar, i cili ka një numër aksionesh më shumë se 10 % të të drejtave të votimit në mbledhjen e aksionarëve;

ii. çdo anëtar i këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës;

iii. çdo person fizik, i cili mban funksionet e administrimit, drejtimit apo kontrollit mbi personin juridik.

37. "Prospekt i plotë" ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit.

38. "Ofertë fillestare e tokenit digjital/ monedhës virtuale (ICO)" është metodë për të grumbulluar fonde, e ndryshme nga një STO, në të cilën një emetues i tokenëve digjitalë dhe/ose monedhave virtuale i ofron ato brenda ose jashtë Shqipërisë, në këmbim të kapitalit, në përputhje me këtë ligj.

39. "Tarifa e kërkesës për autorizimin e ICO- s/STO-së" është tarifa që duhet të paguhet nga emetuesi për autorizimin e prospektit të plotë/aktofertës apo relacionit prezantues, në përputhje me këtë ligj.

40. "Ofruesi i shërbimit inovativ" është person juridik që ofron shërbime të teknologjisë inovative, i licencuar në përputhje me këtë ligj.

41. "Licenca e ofruesit të shërbimit inovativ" është licenca e lëshuar nga AKSHI si ofrues i shërbimeve inovative, në përputhje me këtë ligj.

42. "Marrëveshjet e teknologjisë inovative" janë kontratat e zgjuara dhe çdo *software* që përdoret për projektimin, programimin e implementimin e shërbimeve të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë.

43. "Tarifat e procedurave të aplikimit për certifikimin e marrëveshjeve të teknologjisë inovative" janë tarifat që duhet të paguhen nga subjekti kërkues për t'u certifikuar, në përputhje me këtë ligj.

44. "Shërbimet inovative teknologjike" janë shërbimet e auditit e të oponencës teknike të marrëveshjeve të teknologjisë inovative dhe të administrimit teknik, që ofrohen nga ofruesit e shërbimit inovativ.

45. "Shoqëri komisionere" ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit.

46. "Shoqëria administruese e fondeve" ose "Shoqëria administruese" ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për sipërmarrjet e investimeve kolektive.

47. "Emetuesi" është një prej ofruesve të shërbimeve të mjeteve virtuale që nënkupton çdo person juridik, i cili emeton token digjital dhe/ose monedha virtuale në përputhje me këtë ligj.

48. "Person juridik privat" është çdo shoqëri, shoqatë, fondacion dhe ente të tjera me karakter privat, sipas përcaktimeve të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Kur ky ligj parashikon se subjekti është ose duhet të jetë person juridik, dispozitat përkatëse do të konsiderohen si të referuara ndaj përfaqësuesit ligjor të një personi juridik në përputhje me ligjin shqiptar.

49. "Licenca" është çdo licencë e lëshuar nga autoriteti përgjegjës sipas këtij ligji.

50. "Tarifat e aplikimit për licencë" janë tarifa që duhet të paguhen nga aplikanti për çdo licencë, në përputhje me këtë ligj.

51. "Titullari i licencës" është çdo person juridik që mban një licencë, në përputhje me këtë ligj.

52. "Tarifa e titullarit të licencës" është tarifa vjetore që titullari i licencës duhet të paguajë, në përputhje me këtë ligj.

53. "Licenca përkatëse nga Banka e Shqipërisë" është licenca përkatëse e lëshuar nga Banka e Shqipërisë për subjektin që ka të drejtën e hapjes së llogarisë në para FIAT, si dhe ndërmjetësimin e transaksioneve monetare, duke përfshirë këtu shërbimin e kujdestarisë, në emër dhe për llogari të klientëve.

54. *"Margin trading"* është veprimtaria e transaksioneve nëpërmjet përdorimit të levës financiare në bursat DLT ose ambientet e tregtimit DLT, ku përdoruesit apo vetë bursat DLT ose ambientet të tregtimit DLT u japin hua përdoruesve, për t'u përdorur si kolateral, me qëllimin e investimit në këto bursa DLT ose ambiente tregtimi DLT, duke marrë interes nga këto hua.

55. "Abuzimi i tregut" është përfshirja në manipulimin e tregut apo tregtimin bazuar në informacion të privilegjuar ose një tentativë për t'u përfshirë në këto veprime, në përputhje me parashikimet e nenit 86, të këtij ligji.

56. "Personi përgjegjës për raportimin e pastrimit të parave" është personi përgjegjës i raportimit të pastrimit të parave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

57. "AKSHI" është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

58. "Person fizik" ka të njëjtin kuptim me përcaktimin e dhënë në Kodin Civil.

59. "Sipërmarrje e paautomatizuar e investimeve kolektive DT" është çdo person juridik ose bashkim asetesh që është i licencuar, i regjistruar apo i njohur si sipërmarrje e investimeve kolektive, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sipërmarrjet e investimeve kolektive, i cili investon në tokenë digjitalë dhe monedha virtuale, por nuk plotëson kriteret teknike për të qenë sipërmarrje e automatizuar e investimeve kolektive DT.

60. "Portofoli i tokenëve digjitalë dhe/ose monedhave virtuale, pa përdorur kujdestar" është

portofol digjital, ku mund të depozitohen e mbahen tokenë digjitalë dhe/ose monedha virtuale, zotëruesi i të cilave është në posedim të çelësit privat për aksesin e këtij portofoli e për të cilin ai mbart përgjegjësi personale.

61. "Aktofertë" ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit.

62. "Person" është çdo person, duke përfshirë, por pa u kufizuar te personat fizikë e juridikë, gjithashtu edhe profesionistët e organizatat e tjera të asociuara, të cilat kanë ose jo personalitet juridik.

63. "Regjistri i sipërmarrjeve të automatizuara DT të investimeve kolektive" është regjistri publik që përmban listën e sipërmarrjeve të automatizuara të investimeve kolektive DT.

64. "Regjistri i bursave DLT të licencuara" është regjistri publik, i cili përmban listën e bursave DLT.

65. "Regjistri i agjentëve DLT të licencuar" është regjistri publik që përmban listën e agjentëve DT.

66. "Regjistri i ofruesve të shërbimit inovativ të licencuar" është regjistri publik, i cili përmban listën e ofruesve të shërbimit inovativ.

67. "Regjistri i kujdestarëve të licencuar për portofolin e palëve të treta" është regjistri publik që përmban listën e kujdestarëve që ofrojnë shërbime për kujdestarinë e portofolit të palëve të treta.

68. "Regjistrat" janë regjistrat publikë që përmbajnë listën e titullarëve të licencave, në përputhje me këtë ligj.

69. "Subjekt i regjistruar në Shqipëri" është një person fizik, i cili rezulton rezident në Shqipëri ose person juridik, i cili është rezident në Shqipëri, sipas legjislacionit tatimor, dhe/ose ka një degë të regjistruar të aktivitetit të tij në Shqipëri, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

70. "Kontratë e zgjuar" është marrëveshje teknologjike, thelbësisht e varur ose e lidhur me një DLT, e cila përmban një set rregullash e kushtesh, të cilat vënë në lëvizje reagime të paracaktuara dhe që vetëzbatohen automatikisht në rast të përmbushjes së kushteve të përcaktuara në të. Kontratat e zgjuara bien nën përkufizimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative, në kuptim të këtij ligji.

71. "Ofertë e një tokeni digjital të titujve (STO)" është një ofertë publike, ku emetuesi i tokenëve të titujve virtualë i ofron ato në Shqipëri ose jashtë saj, në këmbim të fondeve, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

72. "Raporti teknik" është raporti i hartuar në bashkëpunim nga ofruesit e shërbimeve inovative përkatëse, në lidhje me marrëveshjen e teknologjisë inovative.

73. "Kujdestari i portofolit të palëve të treta" është personi juridik (përfshirë këtu bursat e centralizuara DLT), i cili ofron shërbimet e ruajtjes të kujdestarisë së çelësave kriptografikë privatë për llogari dhe në emër të klientëve, si dhe mbajtjen, depozitimin e transferimin e tokenëve digjitalë, i cili gjithashtu zotëron licencën përkatëse nga Banka e Shqipërisë.

74. "Ofruesi i shërbimit jokujdestar i portofolit të palëve të treta" është personi juridik, i cili ofron aplikacione për të mbajtur, ruajtur apo transferuar token digjitalë dhe/ose monedha virtuale, por që nuk është në zotërim të çelësit kriptografik privat të klientëve të tij.

75. "Programi i automatizuar i tregtimit të tokenit" është programi që mund të ekzekutojë transaksione për klientët në një bursë DLT, bazuar në parametrat përkatës.

76. "Ambienti i tregtimit" është personi juridik që vepron si "treg i rregulluar", ose "platformë shumëpalëshe e tregtimit" ose "platformë e organizuar e tregtimit", në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit.

77. "Titujt e transferueshëm" janë:

i. aksionet në shoqëri dhe tituj të tjerë ekuivalentë me aksionet (aksione);

ii. obligacione dhe forma të tjera të borxhit të titullzuar (tituj të borxhit);

iii. çdo formë tjetër e titujve të transferueshëm që zotëron të drejtën për të blerë tituj të transferueshëm nëpërmjet nënshkrimit ose shkëmbimit.

78. Mjetit virtual" ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

79. "Ofrues i shërbimeve të mjeteve virtual" ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

80. Monedha virtuale" është një prej mjeteve virtuale që nënkupton përfaqësimin digjital të vlerës, i cili përdoret si mjet shkëmbimi, instrument pagesash, njësi llogaritjeje ose rezervë vlere dhe që:

i. nuk është një token digjital, sipas përkufizimit të këtij ligji;

ii. nuk është emetuar apo garantuar nga një organ shtetëror;

iii. nuk është domosdoshmërish e lidhur me një monedhë të rregulluar me ligj;

iv. nuk është valutë dhe rrjedhimisht nuk ka kurs ligjor, por është pranuar nga personat fizikë apo juridikë si mjet shkëmbimi;

v. emetohet në platformë të posaçme të teknologjisë së regjistrave të shpërndarë; dhe

vi. mund të transferohet, depozitohet, tregtohet në mënyrë elektronike.

81. “Portofol” është program kompjuterik ose mekanizëm tjetër që ruan *on-line* ose *off-line* çelësat privatë e publikë dhe ndërvepron me DLT për t'i mundësuar përdoruesit të mbajë, të ruajë, të dërgojë, të marrë e të monitorojë tokenët e tij digjitalë dhe/ose monedhat virtuale.

82. “Relacioni prezantues *(Whitepaper)”* është dokument që përmban të gjitha elementet e kërkuara nga ky ligj, sipas natyrës e specifikës së emetuesit dhe tokenit digjital, i cili do t'i mundësojë investitorët të marrin vendime të informuara lidhur me pjesëmarrjen në një ofertë fillestare të tokenit digjital/monedhës virtuale.

Në këtë ligj, fjalët në numrin njëjës përfshijnë ato në numrin shumës dhe anasjelltas, me përjashtim të rastit kur, sipas kontekstit të dispozitës përkatëse, rezulton ndryshe. Përemri vetor “ai” përfshin edhe përemrin vetor “ajo” dhe përemri vetor “ata” i nënkupton të dyja gjinitë, me përjashtim të rastit kur, sipas kontekstit të dispozitës përkatëse, rezulton ndryshe.

## KREU II
## LICENCAT DHE KOMPETENCAT E AUTORITETEVE

### SEKSIONI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 4
#### **Llojet e licencave**

Llojet e licencave që miratohen nga autoritetet përgjegjëse për kryerjen e veprimtarive të parashikuara në këtë ligj janë:

a) licenca e agjentit TD, e cila lëshohet nga AMF-ja për një person juridik, pas plotësimit të kushteve të përgjithshme dhe të kritereve të veçanta, të parashikuara në nenet 9 e 29, të këtij ligji;

b) licenca e bursës DLT, e cila lëshohet nga AMF-ja dhe AKSHI për një person juridik, pas plotësimit të kushteve të përgjithshme dhe të kritereve të veçanta të parashikuara në nenet 9 e 51, të këtij ligji. Licenca e bursës DLT ndahet në tri kategori, si më poshtë:

i. kategoria “A” përfshin licencat e bursës së centralizuar DLT dhe licenca si bursë e decentralizuar DLT, ku mund të tregtohen vetëm “tokenë digjitalë shërbimesh dhe/ose token digjitalë të pagesave” dhe/ose “tokenë digjitalë të aseteve”;

ii. kategoria “B” përfshin licencat e bursës së centralizuar DLT ose dhe licenca si bursë e decentralizuar DLT, ku, krahas aktiviteteve të listuara në kategorinë “A”, mund të tregtohet paraja FIAT dhe/ose monedhat virtuale kundrejt tokenëve digjitalë të shërbimeve, pagesave dhe aseteve e anasjelltas;

iii. kategoria “C” përfshin licencat si bursë e centralizuar DLT dhe licencat e bursat e decentralizuara DLT, ku, krahas aktiviteteve të listuara në licencën e kategorisë “B”, mund të tregtohen edhe tokenë digjitalë të titujve;

c) licenca e ofruesit të shërbimeve inovative, e cila lëshohet nga AKSHI (pa përfshirjen e një agjenti TD) për një person juridik pas plotësimit të kushteve të përgjithshme dhe të kritereve të veçanta, të parashikuara në nenet 9 e 63, të këtij

ç) licenca e kujdestarit të portofolit të palëve të treta, e lëshuar nga AMF-ja dhe AKSHI për një person juridik, pas plotësimit të kushteve të përgjithshme dhe kritereve të veçanta të parashikuara në nenet 9 e 77, të këtij ligji;

d) licenca e sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive DT, e lëshuar nga AKSHI për një sipërmarrje të investimeve kolektive, pas plotësimit të kushteve të përgjithshme dhe kritereve të veçanta, të parashikuara në nenet 9 e 82, të këtij ligji.

Në bursat e centralizuara ose të decentralizuara DLT mund të kryhet gjithashtu edhe veprimtaria e *“Margin Trading”*.

#### Neni 5
#### **Statusi i licencave**

1. Titullari i licencës ushtron veprimtarinë e tij, në përputhje me kushtet dhe kriteret e e përcaktuara në këtë ligj.

2. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, përkundrejt klientëve ose palëve të treta, titullari i licencës bazohet në parimet e mëposhtme:

a) vepron me ndershmëri;

b) trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet, me të cilat krijon marrëdhënie;

c) sillet në mënyrë profesionale;

ç) zbaton të gjitha rregullat e përcaktuara në këtë ligj, në legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe në aktet nënligjore apo rregullatore në zbatim të këtij ligji.

3. AMF-ja dhe AKSHI, në rast të konstatimit të shkeljeve të përcaktimeve të këtij ligji, heqin licencën, në përputhje me rrethanat e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 6

**Vlefshmëria dhe kohëzgjatja e licencave**

1. Licenca do të fillojë të jetë e vlefshme një ditë pas komunikimit të njoftimit nga autoriteti përgjegjës lidhur me miratimin e kërkesës për licencim e do të zgjasë për një kohë të pacaktuar.

2. Përveç rasteve kur AMF-ja dhe/ose AKSHI, sipas rastit, ushtrojnë të drejtën për të hequr licencën, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, licenca pushon së qeni e vlefshme edhe kur titullari i licencës ka njoftuar autoritetet përgjegjëse për heqjen dorë prej saj. Në këtë rast licenca pushon së qeni e vlefshme ditën e pestë të punës, duke filluar nga e nesërmja e datës së njoftimit të AMF-së dhe/ose AKSHI-it për këtë qëllim.

Neni 7

**Kompetencat e autoriteteve**

1. Kompetencat e përgjithshme të secilit autoritet janë si më poshtë:

a) AKSHI vlerëson të gjitha kushtet e kriteret teknologjike të paraqitura nga subjekti kërkues, në rastet kur AKSHI ka kompetencë ekskluzive ose të përbashkët për dhënien e licencës, të autorizimit ose të certifikimit;

b) AMF-ja vlerëson të gjitha aspektet financiare dhe ato rregullatore, në përputhje me këtë ligj, në rastet kur AMF-ja ka kompetencë ekskluzive ose të përbashkët për dhënien e licencës, të autorizimit ose të certifikimit.

2. Kjo ndarje e kompetencave zbatohet në dhënien e licencave, të autorizimeve ose të certifikimeve, në përputhje me këtë ligj.

3. Në rastin kur dhënia e një licence apo autorizimi është në kompetencë të të dyja autoriteteve përgjegjëse, asnjë licencë ose autorizim nuk mund të lëshohet, përveç rastit kur të dyja autoritetet përgjegjëse shprehen me vendim, sipas parashikimeve të këtij ligji. Nëse njëri prej dy autoriteteve përgjegjëse refuzon licencën ose autorizimin, subjekti konsiderohet pa licencë apo që nuk ka marrë autorizim.

Neni 8

**Koordinimi ndërmjet autoriteteve**

1. Në rast të përfshirjes së të dyja autoriteteve përgjegjëse në miratimin e lëshimin e licencës përkatëse ose në rast të ushtrimit të çdo lloj detyre të përbashkët të përcaktuar në këtë ligj, koordinimi ndërmjet autoriteteve përgjegjëse do të jetë si më poshtë:

a) gjatë procedurës së licencimit, në rast se njëri nga autoritetet përgjegjëse konstaton nevojën për të kërkuar sqarime, informacion ose dokumentacion plotësues për subjektin kërkues, ky autoritet informon edhe autoritetin tjetër për informacionin/dokumentacionin plotësues që ka marrë nga subjekti kërkues;

b) nëse njëri nga autoritetet shprehet lidhur me miratimin ose jo të kërkesës për licencim, autoriteti në fjalë duhet të informojë menjëherë autoritetin tjetër, duke i vënë në dispozicion këtij të fundit një kopje të vendimit, brenda së njëjtës ditë pune dhe, në çdo rast, jo më vonë se dita pasardhëse e punës;

c) në rast të miratimit të kërkesës për licencim nga të dyja autoritetet përgjegjëse, AMF-ja, sapo të marrë dijeni për vendimet përkatëse, njofton subjektin kërkues brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj, si dhe regjistron vendimin/et në regjistrin përkatës të licencave brenda 5 ditëve pune;

ç) në rast se AKSHI kërkon të ushtrojë kompetencat e informimit, të përcaktuara në nenin 18, të këtij ligji, ky autoritet informon menjëherë AMF-në, e cila njofton titullarin e licencës, duke i dërguar edhe AKSHI-t një kopje të njoftimit. AMF-ja, gjithashtu, vë në dispozicion AKSHI-t të gjithë dokumentacionin e marrë lidhur me praktikën.

2. Në rastet kur vetëm njëri prej autoriteteve është përgjegjës për dhënien e licencës dhe/ose autorizimit ose për ushtrimin e ndonjë kompetence tjetër që i është dhënë në bazë të këtij ligji, ky autoritet informon menjëherë autoritetin tjetër për çdo vendim të marrë lidhur me çështjen në fjalë, duke i dërguar këtij të fundit një kopje të vendimit.

SEKSIONI II
KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE APLIKIMI PER LICENCË

Neni 9
**Kushtet e përgjithshme për licencim**

1. Çdo subjekt kërkues për licencim duhet të provojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet agjentit TD (sipas rastit), se përmbush të gjitha kushtet e përgjithshme të përcaktuara në këtë nen, si më poshtë:

a) të vërtetojë, nëpërmjet mandatit të arkëtimit, pagesën e tarifës përkatëse të aplikimit për licencë;

b) të vërtetojë, nëpërmjet dokumentit të lëshuar nga organi përkatës, që subjekti është i regjistruar në Shqipëri si shoqëri aksionare;

c) të vërtetojë, nëpërmjet dokumentacionit provues, se ka emëruar këshillin e administrimit ose, sipas rastit, këshillin mbikëqyrës dhe të vërtetojë, nëpërmjet një vetëdeklarimi se:

i. anëtarët përkatës të tyre kanë reputacion profesional e personal të mirë, kanë njohuri, aftësi dhe përvojë të mjaftueshme, do të angazhohen me kohë të mjaftueshme për të kryer detyrat e tyre dhe janë në gjendje të kuptojnë qartësisht llojin e aktiviteteve e rreziqet që lidhen me to; dhe

ii. subjekti kërkues do të alokojë burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për trajnimin e anëtarëve të këshillit të administrimit ose, sipas rastit, këshillit mbikëqyrës;

ç) të vërtetojnë, nëpërmjet certifikimit nga AKSHI, se marrëveshja e teknologjisë inovative është në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Subjekti kërkues, për t'u licencuar si agjent TD dhe/ose ofrues i shërbimeve inovative, përjashtohet nga zbatimi i kësaj pike;

d) të vërtetojë, duke siguruar një kopje të dokumentit përkatës, se ka emëruar një person përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave në nivele administrimi/drejtimi në zyrën qendrore dhe në çdo zyrë përfaqësimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

dh) të vërtetojë që plotëson kriteret e të qenit "i aftë dhe i përshtatshëm" për ushtrimin e veprimtarive përkatëse;

e) të vërtetojë, nëpërmjet dokumentacionit provues, se shoqëria ka miratuar rregullore të brendshme të funksionimit, të cilat përmbajnë:

i. masa dhe politika parandaluese për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

ii. masa dhe politika efikase për identifikimin e menaxhimin e konfliktit të interesave;

iii. masa dhe politika efikase për parandalimin e mashtrimit dhe abuzimit me tregun.

2. Llojet dhe përmbajtja e dokumentacionit që nevojitet për zbatimin e këtij neni përcaktohen me aktet nënligjore rregullatore respektive të secilit autoritet përgjegjës në zbatim të këtij ligji.

3. Për qëllime të këtij neni, autoritetet përgjegjëse, përmes akteve nënligjore rregullatore respektive, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, sipas këtij ligji, mund të miratojnë rregulla më të detajuara, lidhur me kushtet e përgjithshme, kriteret e veçanta ose kritere të tjera shtesë.

Neni 10
**Aplikimi për licencë**

1. Pas plotësimit të formularit të aplikimit, subjekti kërkues e dorëzon atë pranë autoritetit përgjegjës, në përputhje me përcaktimet e nenit 8, të këtij ligji, duke bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin provues për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të kritereve të veçanta, si dhe çdo kërkesë tjetër të këtij ligji. Aplikimi për licencim dhe dokumentacioni provues mund të dorëzohen edhe në formë elektronike, sipas rregullave të përcaktuara nga AMF-ja, të cilat mund të parashikojnë edhe aplikimin e teknologjisë së regjistrave të shpërndarë.

2. Autorizohet autoriteti përgjegjës për nxjerrjen e rregulloreve për zbatimin e këtij neni.

3. Në rastet kur kërkohet miratimi ekskluziv nga AMF ose miratimi i përbashkët i AKSHI-t dhe AMF-së, aplikimi regjistrohet në AMF. Brenda 2 ditëve pune nga data e regjistrimit të aplikimit, AMF-ja i dërgon AKSHI-t aplikimet përkatëse për licencim, duke i bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin provues e mbështetës. Në rastin kur vetëm njëri prej autoriteteve është përgjegjës për miratimin dhe lëshimin e licencës, aplikimi me të gjithë dokumentacionin provues e mbështetës regjistrohet tek autoriteti përgjegjës.

Aplikimi për licencë të bursës DLT dhe/ose kujdestarit të portofolave të palëve të treta duhet të dorëzohet përmes një agjenti TD të licencuar, i cili emërohet nga subjekti kërkues për të kryer të gjitha procedurat e licencimit në emër dhe për llogari të këtij të fundit. Agjenti TD do të kryejë, në masën që është

e zbatueshme, detyrat dhe aktivitetet e përcaktuara në kreun III, të këtij ligji.

4. Aplikimi për licencë të sipërmarrjeve të automatizuara të investimeve kolektive DT duhet të dorëzohet nëpërmjet një ofruesi të shërbimeve inovative të licencuar, i cili emërohet nga subjekti kërkues për të kryer të gjithë procedurën e licencimit në emër e për llogari të tij. Ofruesi i shërbimeve inovative kryen, deri në masën që është e zbatueshme, detyrat dhe aktivitetet e përcaktuara në kreun VI, të këtij ligji.

SEKSIONI III
PROCEDURA E LICENCIMIT DHE KOMPETENCAT E AUTORITETEVE

Neni 11
**Afatet e procedures së licencimit**

Autoriteti përgjegjës merr vendim lidhur me licencimin brenda 60 ditëve kalendarike nga data e dorëzimit të aplikimit dhe dokumentacionin provues nga vetë subjekti kërkues ose nëpërmjet agjentit TD, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 12
**Kompetencat e autoriteteve gjatë procedurës së licencimit**

1. AMF-ja apo AKSHI mund të kërkojnë sqarime të mëtejshme ose dokumentacion plotësues nga subjekti kërkues, brenda afatit të 60 ditëve kalendarike, përcaktuar në nenin 11, të këtij ligji.

2. Kërkesa për sqarime të mëtejshme dhe/ose dokumentacioni plotësues duhet të jetë e mirargumentuar dhe duhet të përmbajë arsyet specifike të lidhura me këtë kërkesë.

3. Në rastet kur autoriteti përgjegjës i dërgon subjektit kërkues kërkesa për sqarime dhe/ose dokumentacion plotësues, afati 60-ditor i përcaktuar në nenin 11, të këtij ligji, pezullohet deri në momentin kur subjekti kërkues ose, sipas rastit, agjenti TD dorëzon pranë AMF-së sqarimet dhe/ose dokumentacionin e kërkuar. Nëse subjekti kërkues nuk arrin të sigurojë sqarimet dhe/ose dokumentacionin e kërkuar brenda 10 ditëve punë, (ose kur në varësi të rrethanave, AMF-ja vendos për një afat më të gjatë, por jo më shumë se 20 ditë punë), aplikimi për licencim quhet automatikisht i refuzuar.

4. Brenda 1 dite pune nga marrja në dorëzim e sqarimeve dhe/ose dokumentacionit plotësues nga subjekti kërkues, AMF-ja dërgon një kopje të dokumentacionit tek AKSHI, në rast se kërkesa për sqarime dhe/ose dokumentacion plotësues ka ardhur nga kjo e fundit.

5. Me qëllim shqyrtimin tërësor nga ana e autoritetit përgjegjës të sqarimeve dhe/ose dokumentacionit plotësues të dorëzuar nga subjekti kërkues ose, sipas rastit, nga agjenti TD, përllogaritja e ditëve të mbetura nga afati i 60 ditëve kalendarike, i përcaktuar në nenin 11, të këtij ligji, do të rifillojë vetëm 3 ditë pune pas marrjes në dorëzim të sqarimeve dhe/ose dokumentacionit plotësues të kërkuar.

Neni 13
**Refuzimi i dhënies së licencës**

Autoritetet përgjegjëse refuzojnë dhënien e një licence në rast të plotësimit të një prej shkaqeve të mëposhtme:

a) mospagesa e tarifës për aplikimin për licencë nga ana e subjektit kërkues;

b) autoritetet përgjegjëse, pas shqyrtimit të aplikimit, gjykojnë mbi baza të arsyeshme se subjekti kërkues ka dorëzuar dokumentacion dhe/ose informacion të rremë, të pasaktë ose jo të plotë;

c) autoritetet përgjegjëse, pas shqyrtimit të aplikimit, gjykojnë mbi baza të arsyeshme se dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti kërkues është i pamjaftueshëm dhe/ose subjekti kërkues nuk përmbush kushtet e kriteret për licencim;

ç) autoritetet përgjegjëse, pas shqyrtimit të aplikimit, gjykojnë mbi baza të arsyeshme se subjekti kërkues nuk do të jetë i aftë të plotë

sojë në të ardhmen kushtet e kriteret për licencim.

SEKSIONI IV
DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË TITULLARIT TË LICENCËS

Neni 14
**Pagesa e tarifës vjetore të titullarit të licencës**

1. Pas licencimit, çdo titullar i licencës i paguan AMF-së dhe AKSHI-t tarifën vjetore të titullarit të licencës.

2. Tarifa vjetore të titullarit të licencës, si dhe procedurat e pagesës përcaktohen me akte nënligjore ose rregullatore për secilin autoritet përgjegjës.

Neni 15

**Veprimtaria dhe shmangia e konfliktit të interesit**

1. Titullari i një licence ushtron veprimtarinë e tij vetëm brenda kushteve dhe fushës së veprimtarisë, për të cilën është lëshuar kjo licencë.

2. Në rastet kur titullari i licencës kërkon të ushtrojë një veprimtari tjetër, për të cilën nevojitet një licencë e re, ai duhet të aplikojë dhe t'u nënshtrohet procedurave dhe kritereve për licencim, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe/ose legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Në rast se titullari i licencës ekzistuese konstaton se ushtrimi i veprimtarisë së re e vë atë në kushtet e konfliktit të interesit me veprimtarinë ekzistuese, përpara aplikimit për licencën e re, merr masat e nevojshme për shmangien bindshëm të konfliktit të interesit dhe informon autoritetin përgjegjës për masat e marra prej tij.

4. Në rast se prezenca e konfliktit të interesit konstatohet nga autoritetet përgjegjëse gjatë shqyrtimit të kërkesës për aplikim, këto autoritete e kthejnë aplikimin pa veprim te kërkuesi, duke e orientuar atë për mënyrën e shmangies së konfliktit të interesit. Kërkuesi mund ta ridërgojë kërkesën për aplikim pranë autoritetit përgjegjës, pas plotësimit të kërkesave të këtij të fundit. Kjo kërkesë konsiderohet si një kërkesë e re.

5. Në rast se autoritetet përgjegjëse edhe pas riaplikimit konstatojnë se konflikti i interesit nuk është shmangur, e refuzojnë kërkesën dhe njoftojnë për këtë qëllim kërkuesin.

6. Për qëllime të zbatimit të këtij neni, autoritetet përgjegjëse miratojnë procedurat dhe rregullat e detajuara për mënyrën e shmangies së konfliktit të interesit.

Neni 16

**Përgjegjësitë e përgjithshme në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit**

Me përjashtim të ofruesve të shërbimeve inovative, çdo titullar i licencës, çdo emetues i tokenëve digjitalë, si dhe çdo person tjetër që ofron shërbime në lidhje me tokenët digjitalë, konsiderohet si ofrues i shërbimeve të mjeteve virtuale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe duhet të përmbushë çdo detyrim, duke përfshirë, por pa u kufizuar, si më poshtë:

a) të ushtrojë vigjilencën e duhur/apo të zgjeruar ndaj klientëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe ligjeve të tjera në fuqi;

b) të krijojë një sistem të sigurt për monitorimin e raportimin e transaksioneve, në përputhje me ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” dhe ligjeve të tjera në fuqi;

c) të kryejë një vlerësim të riskut ndaj klientëve dhe ta rishikojë atë në mënyrë periodike;

ç) të raportojë transaksionet e dyshimta tek autoritet përkatëse, në përputhje me ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;

d) të zbatojë çdo detyrim tjetër që rrjedh nga ligji “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” për ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale.

Neni 17

**Deklarata e përputhshmërisë së titullarit të licencës**

1. Brenda muajit të dymbëdhjetë nga data e marrjes së licencës, titullari i saj, nëpërmjet agjentit të tij TD, duhet të dorëzojë pranë AMF-së deklaratën e përputhshmërisë së titullarit të licencës, e cila duhet të përmbajë:

a) një deklarim lidhur me përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe kritereve të veçanta nga ana e titullarit të licencës, si dhe çdo kërkesë tjetër të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë këtu edhe ato teknologjike;

b) informacion të përditësuar lidhur me ndryshimet në strukturën menaxhuese të titullarit të licencës, më konkretisht ndryshimet e administratorëve, të drejtorëve dhe personelit kyç, si dhe ndryshime të rregulloreve të brendshme të funksionimit të titullarit të licencës.

2. Deklarata e përputhshmërisë së titullarit të licencës nënshkruhet bashkërisht nga titullari i

licencës dhe agjenti i tij TD.

3. Për qëllime të zbatimit të këtij neni, AMF-ja përcakton formatin e deklaratës së përputhshmërisë, si dhe mënyrën e kushtet e hartimit të saj me rregullore.

4. Agjentët TD dhe ofruesit e shërbimeve inovative përjashtohen nga zbatimi i këtij neni.

SEKSIONI V
KOMPETENCAT E AUTORITETEVE
KUNDREJT TITULLARIT TË LICENCËS

Neni 18
**Kompetencat e informimit e të hetimit kundrejt titullarit të licencës**

1. Pas përfundimit të procedurës së licencimit, në rastet kur AMF-ja e gjykon të arsyeshme, ajo mund të ushtrojë një ose më shumë nga kompetencat e mëposhtme edhe në bashkëpunim me AKSHI-n:

a) kompetencat e informimit:

Mund t'i kërkojë me shkrim ose elektronikisht titullarit të licencës:

i. të japë informacion dhe/ose dokumentacion provues sipas formës e afateve të përcaktuara në kërkesën për informacion;

ii. të marrë pjesë në takime, si dhe t'u përgjigjet pyetjeve të autoriteteve përgjegjëse, duke vënë në dispozicion të gjithë informacionin e dokumentacionin provues lidhur me kërkesën e këtyre të fundit;

iii. në rastet kur titullari i licencës nuk disponon informacionin dhe/ose dokumentacionin provues të kërkuar, t'u tregojë autoriteteve, për aq sa ai ka dijeni, për vendndodhjen e informacionit dhe/ose të dokumentacionit provues të kërkuar;

iv. të ndërmarrë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar informacionin dhe/ose dokumentacionin e kërkuar nga autoritetet;

b) kompetencat e hetimit administrativ dhe e drejta për të lëshuar urdhërbllokime:

i. nëse AMF-ja gjykon se, me qëllim mbrojtjen e interesave të klientëve ose të tregut në tërësi, është i nevojshëm hetimi i titullarit të licencës, mund të iniciojë, në bashkëpunim me AKSHI-n, hetim administrativ të aktivitetit të këtij të fundit;

ii. AMF-ja, kur gjykon se përbën rrezik që personi në hetim administrativ mund të dëmtojë investitorët, me vendim, mund të urdhërojë bllokimin e llogarive bankare të personit nën hetim. Kujdestari i portofolave të palëve të treta, si dhe bursa DLT janë të detyruar të zbatojnë këtë vendim menjëherë pas marrjes së njoftimit. Kur kujdestari i portofolit të palëve të treta dhe bursa DLT nuk zbatojnë vendimin e bllokimit, ato bëhen përgjegjës për moszbatimin e vendimit e detyrohen të dëmshpërblejnë investitorët, në rast se personi në fjalë i ka dëmtuar si rrjedhojë e moszbatimit të tij;

iii. AMF-ja, para zhbllokimit të llogarive bankare të personit nën hetim administrativ, mund të kërkojë garanci të përshtatshme në funksion të mbrojtjes së interesave të investitorëve;

c) inspektimet në vend:

Çdo zyrtar i autoriteteve përgjegjëse, duke paraqitur dokumentin identifikues të autoritetit dhe autorizimin përkatës, mund të hyjë në ambientet që zotërohen nga titullari i licencës, me qëllim marrjen e informacionit ose të dokumenteve dhe/ose të çdo prove tjetër të nevojshme për qëllime të hetimit e të ushtrimit të kompetencave në përputhje me këtë nen.

2. Autoritetet përgjegjëse mund të kërkojnë asistencën e organeve të rendit ose subjektet private të licencuara për këtë qëllim, në ushtrimin e kompetencave të mësipërme.

Neni 19
**Pezullimi dhe heqja e licencës**

1. AMF-ja (në rastet kur ka kompetencë ekskluzive ose të përbashkët me AKSHI-n) dhe AKSHI (në rastet kur ka kompetencë ekskluzive) mund të pezullojnë dhe/ose heqin licencën e titullarit të saj në rastet e mëposhtme:

a) kur titullari i licencës nuk arrin të përmbushë kushtet e përgjithshme dhe/ose kriteret e veçanta të përcaktuara në këtë ligj;

b) kur titullari i licencës u ka dhënë autoriteteve përgjegjëse informacion të pavërtetë ose në mënyrë të parregullt;

c) kur është në kundërshtim ose nuk përmbush më një ose më shumë nga kushtet e përgjithshme dhe/ose kriteret e veçanta të parashikuara nga ky ligj;

ç) kur konstatohen shkelje të dispozitave ligjore të këtij ligji apo të akteve nënligjore në zbatim

të tij.

2. Në të tilla raste, AMF-ja (në rastet kur ka kompetencë ekskluzive ose të përbashkët me AKSHI-n) dhe AKSHI (në rastet kur ka kompetencë ekskluzive) pezullojnë licencën dhe i japin titullarit të saj një afat prej 15 ditësh pune (ose, në varësi të rrethanave, një afat më të gjatë, por jo më shumë se 25 ditë pune nga data e njoftimit të vendimit që shpjegon arsyet e pezullimit), për të parashtruar qëndrimet e tij lidhur me vendimin e pezullimit e licencës.

3. Nëse titullari i licencës nuk arrin të përgjigjet brenda afatit të përcaktuar më sipër, autoriteti përgjegjës heq licencën, duke argumentuar në vendim arsyet e heqjes.

4. Licenca, gjithashtu, mund të hiqet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga autoritetet përgjegjëse në rastet e mëposhtme:

a) kur titullari i licencës nuk fillon veprimtarinë, për të cilën është licencuar, brenda 6 muajve nga data e lëshimit të licencës;

b) kur titullari i licencës bëhet subjekt i një procesi likuidimi ose shpall falimentin;

c) nëse ndonjë autoritet tjetër, që disponon kompetenca rregullatore në lidhje me titullarin e licencës, kërkon me shkrim dhe mbi baza të arsyeshme heqjen e licencës;

ç) në qoftë se agjenti DT i emëruar nga mbajtësi i licencës nuk dorëzon deklaratën vjetore të përputhshmërisë së titullarit të licencës (sipas rastit), brenda afatit dhe në përputhje me nenin 17, të këtij ligji, ose në qoftë se agjenti DT nuk dorëzon deklaratën vjetore të përputhshmërisë së titullarit të licencës për shkak të mosplotësimit të kushteve dhe kritereve përkatëse;

d) kur titullari i licencës ka hequr dorë vullnetarisht nga licenca;

dh) kur titullari i licencës ka pushuar së ekzistuari si person juridik.

Neni 20

**Transferimi i licencës**

1. Titullari i licencës nuk mund të delegojë ose ta transferojë licencën te një palë e tretë, pa miratimin paraprak me shkrim të autoritetit përgjegjës.

2. Titullari i licencës duhet të njoftojë paraprakisht autoritetin përgjegjës për çdo qëllim të tijin lidhur me delegimin ose transferimin e licencës te një palë e tretë.

3. Autoriteti përgjegjës miraton ose refuzon delegimin apo transferimin e licencës brenda 15 ditëve pune nga data e njoftimit. Në çdo rast miratimi i delegimit apo transferimit të licencës bëhet vetëm nëse personi juridik që kërkohet t'i delegohet apo transferohet licenca plotëson kushtet e përcaktuara nga ky ligj.

4. Çdo delegim ose transferim i licencës në kundërshtim me këtë nen konsiderohet si akt absolutisht i pavlefshëm.

5. Autoriteti përgjegjës mund të pezullojë ose të heqë licencën e titullarit në rast të shkeljes së këtij neni.

Neni 21

**Pjesëmarrja influencuese e titullarit të licencës**

1. Titullari i licencës do të njoftojë paraprakisht autoritetin përgjegjës për çdo qëllim të tijin që lidhet me pjesëmarrjen influencuese të titullarit të licencës.

2. Autoriteti përgjegjës miraton ose refuzon pjesëmarrjen influencuese brenda 15 ditëve punë nga momenti i njoftimit.

3. Çdo transaksion, i cili lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me pjesëmarrjen influencuese e që është në kundërshtim me këtë nen, konsiderohet si akt absolutisht i pavlefshëm.

4. Autoriteti përgjegjës mund të pezullojë ose të heqë licencën në rast të shkeljes së këtij neni.

5.Autoriteti përgjegjës përcakton rregulla të mëtejshme për pjesëmarrjen influencuese.

SEKSIONI VI

REGJISTRAT

Neni 22

**Dispozita të përgjithshme për regjistrat**

1. Çdo regjistër i parashikuar në këtë seksion do të jetë në dispozicion të publikut për konsultim e do të përditësohet brenda 5 ditëve punë nga data e njoftimit të titullarit të licencës lidhur me vendimin për

miratimin, refuzimin ose, sipas rastit, pezullimin ose heqjen e licencës. Regjistrimi i licencave dhe çdo vendim tjetër i autoriteteve duhet të kryhet sipas përcaktimeve të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, duke përfshirë këtu përdorimin e teknologjisë të regjistrave të shpërndarë.

2. Çdo regjistër i parashikuar në këtë kre do të përditësohet rregullisht dhe, në çdo rast, të paktën çdo 12 muaj, duke filluar nga data në të cilën licenca është lëshuar e duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm lidhur me titullarin e licencës:

a) numrin e protokollit/eve dhe data/at e vendimeve të marra nga autoriteti përgjegjës që ka lëshuar licencën përkatëse;

b) emrin e personit juridik;

c) selinë qendrore;

ç) adresën zyrtare të *e-mail-it* të agjentit DT (nëse aplikohet) dhe të titullarit të licencës;

d) referimin e çdo vendimi tek autoritetet përgjegjëse, nëpërmjet të cilit këto autoritete kanë ndërmarrë sanksione ndaj titullarit të licencës, në përputhje me këtë ligj;

dh) konfirmimin e marrjes në kohë të deklaratës së përputhshmërisë të titullarit të licencës (nëse aplikohet).

3. Procedurat e hollësishme të plotësimit dhe të ruajtjes së regjistrave përcaktohen nëpërmjet akteve rregullatore të miratuara nga autoritetet përgjegjëse brenda fushës së përgjegjësisë, sipas këtij neni.

Neni 23

**Regjistri i agjentëve TD të licencuar**

Çdo agjent DT, i cili posedon një licencë si agjent TD, duhet të regjistrohet në regjistrin e agjentëve TD të licencuar, i rregulluar dhe i mirëmbajtur nga AMF-ja.

Neni 24

**Regjistri i bursave të licencuara DLT**

Çdo bursë e licencuar DLT duhet të regjistrohet në regjistrin e bursave DLT, i rregulluar dhe i mirëmbajtur nga AMF-ja, i cili specifikon nëse bursa DLT përkatëse ka marrë një licencë të kategorisë “A”, “B” ose “C”.

Neni 25

**Regjistri i ofruesve të shërbimit inovativ**

Çdo ofrues i shërbimeve inovative, që posedon një licencë për ofrimin e shërbimeve inovative, duhet të regjistrohet në regjistrin e ofruesve të shërbimit inovativ të licencuar, i cili rregullohet dhe mirëmbahet nga AKSHI.

Neni 26

**Regjistri i ofruesve të kujdestarisë ndaj portofolit të palëve të treta**

Çdo ofrues i kujdestarisë së portofolit të palëve të treta, që posedon një licencë për ofrimin e kujdestarisë ndaj portofolit të palëve të treta, regjistrohet në regjistrin e ofruesve të kujdestarisë për palët e treta, i rregulluar dhe i mirëmbajtur nga AMF-ja.

Neni 27

**Regjistri i sipërmarrjeve të investimeve kolektive të automatizuara**

Çdo sipërmarrje e automatizuar e investimeve kolektive DT, që posedon një licencë, regjistrohet në regjistrin e sipërmarrjeve të automatizuara të investimeve kolektive DT, i rregulluar dhe i mirëmbajtur nga AKSHI.

KREU III

AGJENTI I TOKENIT DIGJITAL (TD)

Neni 28

**Dispozita të përgjithshme**

1. Çdo person juridik që dëshiron të ushtrojë aktivitetin si agjent TD, në përputhje me këtë ligj, duhet të disponojë licencën përkatëse të lëshuar nga AMF-ja, si dhe të jetë i regjistruar në regjistrin e agjentëve të licencuar TD, në përputhje me nenin 23, të këtij ligji.

2. Shërbimet dhe aktivitetet e përcaktuara për agjentët TD mund të kryhen vetëm nga ata agjentë, të cilët disponojnë një licencë agjenti TD dhe vetëm gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës.

Neni 29

**Kriteret e veçanta për agjentët e tokenit digjital (TD)**

1. Krahas kushteve të përgjithshme të parashikuara në kreun II, të këtij ligji, subjekti kërkues për licencë agjenti TD duhet të plotësojë edhe kriteret e veçanta, si më poshtë:

a) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion dokumentacionin provues, se ka aftësitë dhe njohuritë e duhura teknike dhe ligjore për të ushtruar veprimtarinë e lidhur me agjentët TD;

b) të vërtetojë se ka një kapital fillestar minimal prej 18.000.000 (tetëmbëdhjetë milionë) lekësh, duke vënë në dispozicion kopjen e dokumentit përkatës/garancinë e lëshuar nga banka.

2. Shqyrtimi dhe vlerësimi lidhur me plotësimin e kritereve të veçanta së bashku me dokumentacionin përkatës kryhet nga AMF-ja.

3. Dokumentacioni përkatës duhet t'i bashkëlidhet aplikimit e duhet të jetë në origjinal ose kopje e noterizuar e tij.

4. Me qëllim garantimin e një niveli të përshtatshëm profesionalizmi, subjekti kërkues për licencë agjenti TD, ose, sipas rastit, agjenti i licencuar TD, duhet të vërtetojë se ka kryer dhe do të vazhdojë të kryejë rregullisht programe të detyrueshme trajnimi.

5. Subjekti kërkues për licencë agjenti TD ose, sipas rastit, agjenti i licencuar TD duhet të përmbushë çdo detyrim shtesë që mund të lindë si rrjedhojë e akteve nënligjore të nxjerra në vazhdimësi. Aktet nënligjore, të cilat ndikojnë në veprimtarinë dhe/ose kushtet dhe kriteret e licencimit të agjentëve TD, të cilët janë licencuar përpara hyrjes në fuqi të këtyre akteve, shtrijnë efektin te këta agjentë TD vetëm 15 dite pune pas hyrjes në fuqi të tyre. AMF-ja, sipas rastit, mund të përcaktojë një afat më të shkurtër kohor, por jo më të shkurtër se 10 ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore.

6. E njëjta dispozitë zbatohet edhe për subjektet kërkuese, të cilat kanë paraqitur kërkesën për t'u licencuar si agjentë TD përpara hyrjes në fuqi të akteve nënligjore. Në këtë rast, subjekti kërkues mund të kërkojë pezullimin e procedurës së licencimit përgjatë periudhës së përmendur në pikën 5, të këtij neni.

7. Për të ruajtur licencën e agjentit TD, duhet të dorëzojë pranë AMF-së një vetëdeklarim, i cili duhet:

a) të vërtetojë që agjenti TD plotëson të gjitha kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta dhe është në përputhje me të gjitha detyrimet e përcaktuara në këtë ligj; dhe

b) të informojë AMF-në për çdo ndryshim në strukturën menaxhuese të agjentit TD, konkretisht, ndryshimet lidhur me drejtorët, administratorët ose personelin kyç, si dhe ndryshime në rregullat e brendshme të funksionimit të agjentit TD.

8. Brenda muajit janar të çdo viti, agjenti TD është i detyruar të dorëzojë pranë AMF-së dokumentacionin që provon kryerjen e programit të detyrueshëm të trajnimit të vazhdueshëm, me qëllim që t'i mundësojë AMF-së të vlerësojë nëse agjenti TD vazhdon të ketë aftësitë dhe njohuritë e duhura teknike e ligjore për të ushtruar veprimtarinë për të cilën është licencuar.

9. Për qëllime të këtij neni, llojet e dokumentacionit provues, procedurat e depozitimit, mënyra e shqyrtimit dhe e vlerësimit të dokumentacionit, llojet e programeve të trajnimit të detyrueshëm, periodiciteti i trajnimit, si dhe mënyra e vlerësimit të aftësive të përfituara gjatë trajnimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 30

**Konflikti i interesit të agjentëve TD**

1. Për çdo aplikim për licencë, e cila duhet dorëzuar nëpërmjet agjentit TD në emër dhe për llogari të subjektit kërkues, agjenti TD duhet t'i bashkëlidhë aplikimit përkatës edhe një vetëdeklarim të tijin, ku shprehet se ky i fundit është i pavarur nga subjekti kërkues dhe nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me të.

2. Agjenti TD duhet të vijojë të mbetet i pavarur dhe të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesit me titullarin e licencës edhe pas licencimit të këtij të fundit. Për këtë arsye, vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të vijojë t'i bashkëlidhet edhe deklaratës vjetore të përputhshmërisë së titullarit të licencës.

Neni 31
**Detyrat e agjentit TD**

1. Agjenti TD duhet:

a) të ndihmojë subjektin kërkues në të gjitha çështjet që lidhen me veprimtarinë që duhet të kryhet prej tij, me qëllim marrjen dhe mbajtjen në vazhdimësi të licencës përkatëse, si dhe ofron shërbime të tjera që konsiderohen si të nevojshme ose të përshtatshme në përputhje me këtë ligj, sipas specifikës së rastit;

b) të ndihmojë subjektin kërkues ose titullarin e licencës për përmbushjen e të gjitha detyrave dhe përgjegjësive të tyre që rrjedhin nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

c) të garantojë autoritetet përgjegjëse dhe të verifikojë në mënyrë periodike subjektet kërkuese ose titullarët e licencës në lidhje me plotësimin e kushteve të të qenit i aftë dhe i përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse dhe përmbushjes së të gjitha kushteve, detyrave dhe përgjegjësive që rrjedhin nga ky ligj;

ç) të veprojë gjithnjë në mënyrë bashkëpunuese në marrëdhënien me autoritetet përgjegjëse;

d) të mundësojë një komunikim të shpejtë dhe efektiv ndërmjet subjekteve kërkuese ose titullarëve të licencës dhe autoriteteve përgjegjëse në lidhje me çdo kërkesë të paraqitur nga këto të fundit në përputhje me këtë ligj;

dh) të dorëzojë, në emër dhe për llogari të subjektit kërkues ose titullarit të licencës, të gjithë dokumentacionin, informacionin dhe sqarimet e kërkuara nga autoritetet përgjegjëse, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj;

e) të vendosë menjëherë në dijeni autoritetet përgjegjëse për çdo informacion në lidhje me papajtueshmërinë e mundshme të subjektit kërkues ose titullarit të licencës me dispozitat e këtij ligji;

ë) të njoftojë me shkrim ose elektronikisht autoritetet përgjegjëse në rast të dorëheqjes ose të ndërprerjes së emërimit të tij si agjent TD brenda 10 ditëve pune nga data e dorëheqjes ose e ndërprerjes së emërimit, duke parashtruar arsyet përkatëse të lidhura me dorëheqjen ose ndërprerjen e emërimit të tij;

f) të dorëzojë pranë autoriteteve përgjegjëse deklaratën e përputhshmërisë së titullarit të licencës:

i. 12 muaj pas datës së regjistrimit të titullarit të licencës në regjistrin përkatës; dhe

ii. çdo muaj të 12-të të mëpasshëm, në përputhje me kërkesat e këtij ligji;

g) të trajtojë çdo kërkesë tjetër të autoriteteve përgjegjëse dhe/ose çdo autoriteti tjetër shtetëror, në përputhje me këtë ligj;

gj) të sigurojë se ka mjaftueshëm fonde të veta për të mbuluar përgjegjësitë profesionale, forma dhe mënyra e mbajtjes së të cilave përcaktohen me rregullore nga autoriteti.

2. Çdo komunikim i ndërsjellë ndërmjet agjentit TD dhe autoriteteve përgjegjëse, në përputhje me këtë ligj, trajtohet nga agjenti TD në mënyrë konfidenciale e ruhet si sekret profesional.

Neni 32
**Përgjegjësia e agjentëve TD**

Agjenti TD mban përgjegjësi kundrejt çdo subjekti kërkues ose titullari të licencës për të gjitha dëmet që janë shkaktuar, si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e shkeljes së ndonjërës prej detyrave ose përgjegjësive të agjentit TD të përcaktuara në këtë ligj.

KREUIV
OFERTAT E TOKENËVE DIGJITALË DHE/OSE MONEDHAVE VIRTUALE

Neni 33
**Ofertat e tokenëve digjitalë dhe monedhave virtuale**

Ofertat e tokenëve digjitalë dhe/ose monedhave virtuale, të cilat rregullohen nga ky ligj, janë si më poshtë:

a) oferta e tokenit digjital të titujve (STO), kur oferta për publikun parashikohet të ketë një vlerë totale të barasvlershme ose më të lartë se 1 000 000 (një milion) euro ose ekuivalenten e kësaj shume në lekë, brenda një periudhe 12-mujore. Në këtë rast zbatohen dispozitat e nenit 34, të këtij ligji;

b) oferta e tokenit digjital të titujve (STO), kur oferta për publikun parashikohet të ketë një vlerë totale më të ulët se 1 000 000 (një milion) euro ose ekuivalenten e kësaj shume në lekë, brenda një periudhe 12-mujore. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 35, të këtij ligji;

c) oferta fillestare e tokenit digjital/monedhës virtuale (ICO), kur oferta për publikun parashikohet të ketë një vlerë totale të barasvlershme ose më të lartë se 8 000 000 (tetë milionë) euro ose ekuivalenten e kësaj shume në lekë, brenda një periudhe 12-mujore. Në këtë rast zbatohen dispozitat e nenit 36, të këtij ligji;

ç) për ofertat fillestare të tokenëve digjitalë/monedhave virtuale, të cilat parashikohen të kenë një vlerë totale më të ulët se 8 000 000 (tetë milionë) euro (ose ekuivalenten e kësaj shume në lekë), brenda një periudhe 12-mujore, do të kërkohet publikimi i një dokumenti informues në lidhje me ofertën, forma dhe përmbajtja e të cilit përcaktohet përmes rregullores së nxjerrë nga AMF-ja. Këto oferta përjashtohen nga zbatimi i kërkesave të neneve 38, 39 dhe neneve 41 deri 49 të këtij ligji.

Neni 34
**Ofertat e tokenit digjital të titujve, që mbartin detyrimin e publikimit të një prospekti të plotë**

Për STO-të, ofertat e të cilave parashikohen të kenë një vlerë totale të barasvlershme ose më të lartë se 1 000 000 (një milion) euro, ose ekuivalentja e kësaj shume në lekë, brenda një periudhe 12- mujore, zbatohen sipas rastit specifik dhe deri në masën që nuk bien ndesh me këtë ligj, parashikimet si më poshtë:

a) dispozitat e legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, në lidhje me kushtet e ofertës dhe prospektit;

b) dispozitat e legjislacionit në fuqi për sipërmarrjet e investimeve kolektive, në rast se emetuesi i tokenëve digjitalë të titujve është një fond i investimeve alternative që u ofrohet klientëve profesionistë.

Neni 35
**Ofertat e tokenit digjital të titujve, që mbartin detyrimin e publikimit të një aktoferte**

Ofertat e tokenit digjital të titujve (STO), të përcaktuara në nenin 33, shkronja “b”, të këtij ligji, përjashtohen nga detyrimi për publikimin e një prospekti të plotë. Për këto STO do të kërkohet publikimi i një aktoferte, sipas përcaktimeve të ligjit “Për tregjet e kapitalit”.

Neni 36
**Oferta fillestare të tokenit digjital dhe/ose monedhës virtuale, që mbartin detyrimin për të publikuar një relacion prezantues**

Oferta fillestare e tokenit digjital (ICO), e përcaktuar në nenin 33, shkronja “c”, të këtij ligji, ka detyrimin e publikimit të një relacioni prezantues, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 37
**Detyrimet e emetuesve**

1. Një emetues duhet:

a) të ushtrojë veprimtarinë e tij me ndershmëri dhe integritet;

b) të ushtrojë veprimtarinë e tij, duke marrë parasysh interesat e nevojat e gjithsecilit prej blerësve të tokenëve digjitalë/monedhave virtuale gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij;

c) të trajtojë në mënyrë të drejtë, të qartë e joabuzive të gjithë blerësit e tokenëve digjitalë/monedhave virtuale;

ç) të ketë një kod të përshtatshëm të qeverisjes korporative;

d) të mirëmbajë protokollet e sistemit e të sigurisë në standardet më të larta të përshtatshme;

dh) të vendosë, vetë ose nëpërmjet një pale të tretë, sisteme për parandalimin, zbulimin e eliminimin e riskut të krimit financiar;

e) të vendosë, vetë ose nëpërmjet një pale të tretë, sisteme për parandalimin, zbulimin e eliminimin e riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

ë) të ketë burime financiare të mjaftueshme.

2. Të gjitha detyrimet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, vlerësohen nga agjenti TD, i cili duhet t'i bashkëlidhë aplikimit për autorizim një vetëdeklarim lidhur me përmbushjen e këtyre detyrimeve nga ana e emetuesit. Në lidhje me kërkesën e përcaktuar në shkronjën “d”, të pikës 1, të këtij neni, agjenti TD mund të delegojë detyrimin për vlerësimin e kritereve teknike përkatëse te një ofrues i shërbimeve inovative.

3. Kur një emetues zotëron një *web*-faqe, ku është i detyruar të publikojë çdo njoftim apo informacion për publikun, sipas përcaktimeve të këtij ligji, ky detyrim konsiderohet i përmbushur në rastet

kur emetuesi publikon një informacion apo njoftim të tillë në *web*-faqen e tij.

Neni 38

**Vendi i lançimit të një STO-je ose ICO-je**

1. Ky ligj zbatohet për STO-të ose ICO-t e lançuara nga një emetues në ose nga Shqipëria. Një STO ose ICO konsiderohet e lançuar në ose nga Shqipëria, nëse emetuesi është subjekt i regjistruar në Shqipëri, sipas përkufizimit të këtij ligji.

2. Tokenët digjitalë të titujve të emetuar përmes një STO-je që nuk është lançuar në ose nga Shqipëria mund të ofrohen në Shqipëri vetëm nëse në legjislacionin përkatës të zbatueshëm interesat e investitorëve nuk janë më pak të mbrojtur se në këtë ligj.

3. Tokenët digjitalë të shërbimeve dhe/ose tokenët digjitalë të pagesave dhe/ose tokenët digjitalë të aseteve, dhe/ose monedhat virtuale të emetuara nëpërmjet një ICO-je, të përcaktuar në nenin 33, shkronja “c”, të këtij ligji, e cila nuk është lançuar në ose nga Shqipëria, mund të ofrohet edhe në Shqipëri, nëse dokumenti i publikuar nga emetuesi i huaj është në thelb ekuivalent me relacionin prezantues *(Whitepaper)*, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe ICO-ja e huaj është në përputhje me të gjitha kushtet e kriteret e parashikuara në këtë ligj.

Neni 39

**Kushtet për lançimin/nisjen e STO-ve dhe ICO-ve**

Lançimi i STO-ve dhe ICO-ve dhe kërkesa për listimin e tregtimin e tokenëve digjitalë dhe/ose monedhave virtuale në bursat DLT dhe ambientet e tregtimit DLT mund të kryhet vetëm pasi emetuesi të ketë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) të emërojë dhe të mbajë një agjent TD përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së STO-së ose ICO- s, i cili do të kryejë detyrat e tij sipas përcaktimeve të kreut III, të këtij ligji;

b) të hartojë, përmes agjentit të emëruar TD, sipas specifikës së rastit, prospektin e plotë/ aktofertën/relacionin prezantues *(Whitpaper)*, i cili duhet të jetë në përputhje me të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj;

c) të dorëzojë tek autoriteti përgjegjës, nëpërmjet agjentit të emëruar TD, kërkesën për autorizimin e STO-së ose ICO-s, duke bashkëlidhur, sipas rastit, prospektin e plotë/ aktofertën/relacionin prezantues *(Whit^epaper);*

ç) të marrë autorizimin me shkrim nga autoritetet përgjegjëse për lançimin/nisjen e STO- së ose ICO-s, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

d) të marrë certifikatën përkatëse për çdo marrëveshje të teknologjisë inovative që është në përdorim në projektimin, programimin dhe implementimin e teknologjisë së regjistrave të shpërndarë.

Neni 40

**Përmbajtja e relacionit prezantues**
***(Whitepaper)***

1. Relacioni prezantues *(Whitepaper)* duhet të përmbajë informacione të detajuara lidhur me emetuesin dhe mënyrën e funksionimit të tokenit digjital të shërbimeve, dhe/ose tokenit digjital të pagesave dhe/ose tokenit digjital të aseteve, dhe/ose monedhës virtuale që do të emetohen përmes ICO-s.

2. Në të gjitha rastet, relacioni prezantues duhet të përmbajë të paktën të gjitha elementet e mëposhtme:

a) të jetë e datuar;

b) të ofrojë informacione lidhur me aktivitetin e emetuesit, duke përfshirë këtu informacione për adresën e selisë qendrore, anëtarët e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës, audituesin (nëse ka) dhe pasqyrat e fundit financiare (vjetore ose gjashtëmujore, nëse është e aplikueshme);

c) të ofrojë informacion të detajuar lidhur me rreziqet kryesore, të parashtrojë specifikat teknologjike të tokenit digjital të shërbimeve dhe /ose të tokenit digjital të pagesave dhe/ose të tokenit digjital të aseteve dhe/ose monedhave virtuale;

ç) në rastin e ICO-s për tokenë digjitalë të shërbimeve, të specifikohet se në cilin aplikacion, shërbim ose të mirë materiale ofrohet qasje nëpërmjet këtij tokeni digjital shërbimi;

d) të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të të gjitha akteve nënligjore në zbatim të tij.

3. Çdo dispozitë (e përfshirë në një kontratë ose çfarëdo lloj dokumenti tjetër), që synon të detyrojë një investitor në një ICO që të heqë dorë nga mbrojtja e të drejtave dhe interesave të tij të garantuar nga ky ligj, duke përfshirë këtu edhe detyrimin për përputhshmërinë e vetë ICO-s me dispozitat e këtij ligji,

konsiderohet si absolutisht e pavlefshme.

4. Autoriteti miraton rregullore lidhur me formën e përmbajtjen e raportit prezantues.

Neni 41
**Kërkesa për autorizim**

1. Subjekti kërkues për autorizimin e një STO-je ose ICO-je duhet të përgatisë dhe të dorëzojë kërkesën përkatëse, nëpërmjet agjentit të emëruar TD, pranë AMF-së. Kërkesa për autorizim dhe dokumentacioni provues mund të dorëzohen edhe në formë elektronike, sipas përcaktimeve të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, të cilat mund të parashikojnë aplikimin e teknologjisë së regjistrave të shpërndarë.

2. Dokumentacioni provues i kërkesës për autorizim duhet të përfshijë:

a) prospektin e plotë/aktofertën/relacionin prezantues *(Whitepaper)*, sipas rastit;
b) vetëdeklarimin e agjentit TD, sipas përcaktimeve në këtë ligj;
c) mandatin e pagesës së tarifave përkatëse të kërkesës për autorizimin e STO-së /ICO-s.

Brenda 1 dite pune nga marrja në dorëzim e kërkesës për autorizim dhe dokumentacionit provues, AMF-ja i përcjell ato pranë AKSHI-t, me qëllim shqyrtimin e marrëveshjeve të teknologjisë inovative dhe aspekte të tjera teknologjike.

3. Gjatë procesit të autorizimit AMF verifikon nëse prospekti i plotë/aktoferta /relacioni prezantues përmban të gjithë informacionin në zbatim të këtij ligji apo akteve nënligjore/ rregulloreve në zbatim të tij. AMF nuk verifikon saktësinë apo vërtetësinë e informacioneve të paraqitura në prospekt/aktofertë/relacion prezantues, si dhe nuk mban përgjegjësi për saktësinë apo vërtetësinë e këtyre informacioneve.

Neni 42
**Afatet e procedurës së autorizimit**

1. AMF-ja, sipas nenit 41, të këtij ligji, shqyrton kërkesën për autorizim së bashku me dokumentacionin provues.

2. AMF-ja vendos për autorizimin e STO-së ose të ICO-s brenda 60 ditëve nga dorëzimi i kërkesës për autorizim nga subjekti kërkues nëpërmjet agjentit TD.

Neni 43
**Kompetencat e AMF-së dhe të AKSHI-t**

Krahas kompetencave të tjera që i janë dhënë AMF-së dhe AKSHI-t në këtë ligj, ato ushtrojnë edhe kompetencat e mëposhtme në lidhje me autorizimin e STO-ve dhe ICO-ve:

1. Gjatë procedures së autorizimit të STO-së ose ICO-s, AMF-ja, me nismën e saj, ose në emër dhe me kërkesë të AKSHI-it, mund:

a) të kërkojë sqarime të mëtejshme, brenda 15 ditëve punë nga dorëzimi i kërkesës për autorizim;

b) të kërkojë përfshirjen e informacioneve plotësuese në prospektin e plotë/ aktofertën/ relacionin prezantues, sipas rastit, ose në reklamimin në *web*-faqen e emetuesit brenda 15 ditëve punë nga data e dorëzimit të kërkesës për autorizim;

c) të kërkojë ndryshime në përmbajtjen e prospektit të plotë/aktofertës/ relacionit prezantues, sipas rastit, ose në reklamat në web- faqen e emetuesit brenda afatit të 60 ditëve punë, të përcaktuara në nenin 42, të këtij ligji, nga data e dorëzimit të kërkesës për autorizim.

Kërkesa/t e AMF-së për sqarime të mëtejshme dhe/ose përfshirje informacioni plotësues dhe/ose ndryshime në përmbajtjen e prospektit të plotë/aktofertës/relacionit prezantues dhe/ose reklamave në *web*-faqen e emetuesit duhet të jetë/jenë të argumentuar/a në mënyrë të arsyeshme, duke pasur qëllim garantimin e mbrojtjes të të drejtave të blerësve të tokenëve digjitalë dhe monedhave virtuale.

Në rastet e kërkesave të mësipërme, afati 60- ditor i përcaktuar në nenin 42, të këtij ligji, pezullohet deri në momentin kur subjekti kërkues dorëzon pranë AMF-së, nëpërmjet agjentit të emëruar TD, sqarimet mëtejshme dhe/ose përfshin informacionin plotësues dhe/ose kryen ndryshimet e kërkuara në përmbajtjen e prospektit të plotë/aktofertës/relacionit prezantues dhe/ose reklamat në *web*-faqen e emetuesit.

Nëse subjekti kërkues nuk arrin të sigurojë sqarimet e mëtejshme dhe/ose të përfshijë informacionin plotësues dhe/ose të kryejë ndryshimet e kërkuara në përmbajtjen e prospektit të plotë/aktofertës/relacionit prezantues brenda 10 ditëve punë (ose kur, në varësi të rrethanave, AMF- ja përcakton një afat më të gjatë, por jo më shumë se 20 ditë pune), kërkesa për autorizim do të quhet automatikisht e refuzuar.

Brenda një dite punë nga dorëzimi i sqarimeve të mëtejshme dhe/ose përfshirjes së informacionit plotësues dhe/ose kryerjes së ndryshimeve të kërkuara në përmbajtjen e prospektit të plotë/aktofertës/relacionit prezantues ose reklamave në *wb*-hiqen e emetuesit nga agjenti TD për llogari të subjektit kërkues, AMF-ja dërgon një kopje të dokumentacionit pranë AKSHI-t, në rastet kur kërkesa ka ardhur nga kjo e fundit.

Me qëllim shqyrtimin tërësor të sqarimeve të mëtejshme dhe/ose përfshirjes së informacionit plotësues dhe/ose kryerjes së ndryshimeve të kërkuara në përmbajtjen e prospektit të plotë/aktofertës/ relacionit prezantues ose reklamat në web-faqen e emetuesit, të dorëzuara nga subjekti kërkues, nëpërmjet agjentit të tij TD, përllogaritja e ditëve të mbetura nga afati 60-ditor i përcaktuar në nenin 42 të do të rifillojë vetëm 3 ditë pune pas marrjes në dorëzim të sqarimeve dhe/ose dokumentacionit plotësues të kërkuar dhe ose kryerjes së ndryshimeve të kërkuara.

2. Pas përfundimit të procedurave të autorizimit të STO-së ose ICO-s, AMF-ja, me nismën e saj dhe/ose në emër dhe me kërkesë të AKSHI-it, mund:

a) të pezullojë STO-në ose ICO-n, nëse një ose të dyja autoritetet përgjegjëse dyshojnë, mbi baza të arsyeshme, se është shkelur një ose më shumë nga dispozitat e këtij ligji. Në këtë rast, vendimi për pezullimin e ICO-s ose STO-së publikohet nga AMF-ja brenda 3 ditëve punë, duke i lënë emetuesit një afat prej 10 ditësh punë për të dorëzuar pranë AMF-së qëndrimet e tij në lidhje me vendimin e pezullimit, së bashku me dokumentacionin mbështetës, sipas kërkesës së AMF-së. Në rast të përgjigjes nga ana e emetuesit brenda afatit të përcaktuar më lart, autoritetet përgjegjëse shqyrtojnë parashtrimet e tij së bashku me dokumentacionin provues dhe vendosin në lidhje me lejimin ose jo të vijimit të ICO-s ose STO-së, subjekt i vendimit për pezullim. Në rast se pas shqyrtimit të përgjigjes së emetuesit autoritetet përgjegjëse gjykojnë se STO-ja ose ICO-ja është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, atëherë këto të fundit do të ndalohen menjëherë;

b) të ndalojë menjëherë STO-në ose ICO-n pa iu nënshtruar fillimisht procedurave të pezullimit, në rast se një ose të dyja autoritetet përgjegjëse kanë në dispozicion prova që vërtetojnë se janë shkelur dispozitat e këtij ligji. Në këtë rast, vendimi për ndalimin e STO-së ose të ICO-s publikohet nga AMF-ja brenda 3 ditëve punë nga momenti i vendimit për ndalimin.

3. Pas përfundimit të procedurave të autorizimit dhe gjatë listimit e tregtimit të tokenëve digjitalë dhe monedhave virtuale përkatëse në një bursë DLT dhe/ose në një ambient tregtimi DLT:

a) AMF-ja, me nismën e saj ose me kërkesë të bursës DLT ose ambientit të tregtimit DLT, në të cilën janë listuar e tregtohen tokenët digjitalë/monedhat virtuale, mund:

i. të pezullojë tregtimin ose kryerjen e transaksioneve me një token digjital/ monedhë virtuale të caktuar, në rast se dyshon mbi baza të arsyeshme, se janë shkelur një ose më shumë dispozita të kreut IV, të këtij ligji; procedurat që do të zbatohen në këtë rast do të jenë analoge me ato të shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij neni;

ii. të urdhërojë heqjen e menjëhershme të tokenit digjital/monedhës virtuale nga bursa DLT ose ambienti i tregtimit DLT, pa iu nënshtruar fillimisht procedurave të pezullimit, në rast se ka në dispozicion prova që vërtetojnë shkeljen e dispozitave të kreut IV, të këtij ligji; Procedurat që do të zbatohen në këtë rast do të jenë analoge me ato të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij neni;

b) bursa DLT ose ambientet e tregtimit DLT, ku janë listuar e tregtohen tokenë digjitalë/monedha virtuale, mund:

i. të pezullojë tregtimin ose kryerjen e transaksioneve me një token digjital/monedhë virtuale të caktuar, në rast se dyshon, mbi baza të arsyeshme, se janë shkelur një ose më shumë dispozita të kreut IV ose tokeni digjital/monedha virtuale në fjalë është në papajtueshmëri me procedurat e vlerësimit, të përcaktuara në kreun V, të këtij ligji; ose

ii. të urdhërojë çlistimin e menjëhershëm të tokenit digjital/monedhës virtuale nga bursa DLT ose ambienti i tregtimit DLT, pa iu nënshtruar fillimisht procedurave të pezullimit, në rast se ka në dispozicion prova që vërtetojnë shkeljen e dispozitave të kreut V, të këtij ligji. Bursa DLT ose ambienti i tregtimit DLT që pezullon ose çliston një token digjital/monedhë virtuale të caktuar, informon AMF-në, duke dhënë arsyet e vendimit për pezullimin dhe/ose çlistimin, jo më vonë se dita pasardhëse e punës nga momenti i marrjes së këtij vendimi. Procedurat që do të zbatohen në këtë rast do të jenë analoge me ato të përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 3, të këtij neni.

4. Gjatë dhe pas procedurës së autorizimit të STO-ve dhe ICO-ve dhe gjatë kohëzgjatjes së tyre, AMF-ja mund:

a) të shpallë publikisht se emetuesi nuk arrin të përmbushë detyrimet e përcaktuara në këtë ligj;

b) të publikojë masat ose sanksionet e ndërmarra kundrejt çdo personi përgjegjës për publikimin, qarkullimin ose shpërndarjen e prospektit të plotë/aktofertës, relacionit prezantues *(Whitepaper);*

c) të kufizojë, deri në ndalimin e plotë, reklamimin/promovimin e STO-së apo ICO-s.

Neni 44
**Refuzimi i autorizimit**

Kërkesa për autorizim të STO-së ose ICO-s do të refuzohet nga AMF-ja dhe/ose AKSHI për shkaqet e mëposhtme:

a) mospagesa e tarifës së kërkesës për autorizimin e STO-së/ICO-s;

b) autoritetet përgjegjëse, pas shqyrtimit të kërkesës, konstatojnë se subjekti kërkues ka dorëzuar dokumentacion dhe/ose informacion të rremë, të pasaktë ose jo të plotë;

c) autoritetet përgjegjëse, pas shqyrtimit të kërkesës, konstatojnë se dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti kërkues është i pamjaftueshëm dhe/ose subjekti kërkues nuk përmbush kushtet për autorizim;

ç) autoritetet përgjegjëse, pas shqyrtimit të kërkesës, gjykojnë mbi baza të arsyeshme se subjekti kërkues nuk mund të vijojë të plotësojë kushtet e kriteret për autorizim në të ardhmen.

Neni 45
**Web-faqja e emetuesit dhe publikimi i prospektit të plotë, elementet e aktofertës, relacionit prezantues *(Whitepaper)***

1. Përmbajtja specifike dhe formati i web-faqes së emetuesit përcaktohet nga aktet rregullatore të miratuara nga AMF-ja sipas këtij neni.

2. Është i ndaluar publikimi i prospektit të plotë/aktofertës/relacionit prezantues në web- faqen e emetuesit ose qarkullimi i tyre në çfarëdolloj forme përpara marrjes së autorizimit përkatës të STO-së ose ICO-s, në përputhje me nenin 42, të këtij ligji.

Neni 46
**Detyrat e agjentit TD**

Gjatë ushtrimit të veprimtarive të lidhura me lançimin/nisjen e një STO-je ose ICO-je, agjenti TD duhet të jetë në përputhje me të gjitha dispozitat e aplikueshme të parashikuara në këtë ligj.

Neni 47
**Veprimtaria promocionale e ICO-ve**

1. Çdo lloj veprimtarie promocionale e lidhur me një ICO ose listimin e tregtimin e tokenit digjital të shërbimeve, tokenit digjital të aseteve, tokenit digjital të pagesave ose monedhave virtuale në një bursë DLT ose ambient tregtimi DLT duhet të jetë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

a) veprimtaria promocionale duhet të identifikohet si e tillë dhe përmbajta e saj nuk duhet të ketë informacion të pasaktë ose të keqinterpretueshëm. Në të gjitha rastet, përmbajtja e reklamave duhet të jetë në përputhje me informacionin e dhënë në relacionin prezantues ose me informacionin që duhet të përmbajë relacioni prezantues, nëse ky i fundit është ende i papublikuar;

b) veprimtaria promocionale duhet të përmbajë një deklaratë, ku të citohet që *Whitepaper*-i është publikuar ose do të publikohet, dhe adresën e kohën, në të cilën kopja e këtij "*hitepaper-i* do të jetë në dispozicion të publikut; dhe

c) të gjitha informacionet lidhur me listimin e tregtimin e tokenit digjital të shërbimeve, tokenit digjital të aseteve, tokenit digjital të pagesave ose monedhave virtuale në një bursë DLT ose ambient tregtimit DLT, të cilat janë bërë të njohura verbalisht apo me shkrim ose elektronikisht, qofshin këto për qëllime promocionale ose jo, duhet të jetë në përputhje me përmbajtjen e relacionit prezantues *(Whitepaper).*

2. Termi "informacion", në kuptimin e këtij neni, përfshin gjithashtu edhe emrin e çdo personi që përkrah raportin prezantues *(Whitepaper)* të emetuesit, si dhe emrin e agjentit TD përkatës. Një informacion i tillë, nëse ekziston, duhet të përfshihet në relacionin prezantues *Whitepaper.*

Neni 48
**Përgjegjësia e emetuesit**

Emetuesi mban përgjegjësi ligjore për të gjitha dëmet që janë shkaktuar drejtpërdrejt, si rrjedhojë e blerjes së tokenëve digjitalë/monedhave virtuale nga një person, përmes ICO-s, STO-së, bursës DLT ose ambientit të tregtimit DLT, në rastet kur blerja në fjalë është bazuar në informacion të rremë, të pasaktë ose jo të plotë të gjendur në prospektin e plotë/aktofertën/relacionin prezantues, dhe/ose web-faqen dhe/ose reklamat e emetuesit.

Përjashtohet nga përgjegjësia ligjore çdo person që:

a) vërteton se ai/ajo kishte baza të arsyeshme për të besuar, pa keqdashje, se informacioni ishte i saktë dhe i vërtetë dhe i plotë; ose

b) në momentin e konstatimit të një informacioni të rremë, të pasaktë ose jo të plotë, ka ndërmarrë menjëherë të gjitha masat e nevojshme për të njoftuar publikun mbi pavërtetësinë, pasaktësinë ose paplotësinë e informacionit në fjalë.

Neni 49
**Llogaria bankare e detyrueshme**

1. Në rast se emetuesi pranon para FIAT në këmbim të tokenëve digjitalë/monedhave virtuale të emetuara përmes një STO-je ose ICO- je, emetuesi detyrohet të hapë një llogari në një bankë ose degë të bankës së huaj me seli në Shqipëri, të licencuar nga Banka e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë, me qëllim depozitimin e këtyre parave.

2. Paratë FIAT të pranuara nga emetuesi qëndrojnë në një llogari bankare të veçuara nga aktivet e bankës/degës së bankës deri në mbylljen e ofertës së STO-së apo ICO-s.

KREU V

BURSA DLT

Neni 50

**Dispozita të përgjithshme për bursat DLT**

1. Çdo person juridik që dëshiron të ushtrojë aktivitetin si bursë DLT, në përputhje me këtë ligj, duhet të disponojë licencën përkatëse të lëshuar nga AMF-ja dhe AKSHI, si dhe të jetë i regjistruar në regjistrin e bursave DLT të licencuara në përputhje me nenin 24, të këtij ligji.

2. Shërbimet dhe aktivitetet e përcaktuara për bursat DLT mund të kryhen vetëm nga ato bursa DLT, të cilat disponojnë licencën përkatëse dhe vetëm gjatë periudhës së vlefshmërisë së kësaj licence.

Neni 51
**Kriteret të veçanta për bursat DLT**

1. Krahas kushteve të përgjithshme, të parashikuara në nenin 9, të kreut II, të këtij ligji, subjekti kërkues për licencë të bursës DLT (ose bursa DLT e licencuar), duhet të plotësojë (gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë si e tillë) kriteret e veçanta si më poshtë:

a) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion kopje të rregullave të brendshme të funksionimit, që ka miratuar, zbatuar e se do të përditësojë në vijim rregullat e brendshme në lidhje me:

i. pezullimin e tregtimit të tokenëve digjitalë/ monedhave virtuale; ngrirjen e transaksioneve me token digjital/monedha virtuale; trajtimin e urdhrave të hapur të blerjes gjatë dhe menjëherë pas periudhës së pezullimit ose ndërprerjeve të platformës, për çfarëdolloj arsyeje; dhe

ii. pezullimin dhe çlistimin e tokenit digjital/monedhës virtuale nga bursa DLT, sipas përcaktimeve të kreut IV, të këtij ligji;

b) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit përkatës, që ka miratuar, zbatuar dhe se do të përditësojë në vijim një program gjithëpërfshirës të menaxhimit të riskut, i cili duhet të përfshijë gjithashtu masat në kuadër të sigurisë kibernetike. Programi i menaxhimit të riskut duhet të jenë në përpjesëtim të drejtë me natyrën, dimensionin, kompleksitetin dhe profilin e riskut të bursës DLT;

c) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit përkatës, që ka miratuar, zbatuar dhe se do të përditësojë në vijim procedurat dhe sistemet e brendshme, me qëllim që të mundësojë garantimin e të drejtës së klientëve e saj për të pasur qasje të drejtpërdrejtë në bursën DLT për të kredituar, tërhequr, ekzekutuar, vendosur dhe kryer urdhra blerjeje ose shitjeje pa ndërmjetësimin e palëve të treta;

ç) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit përkatës, që ka miratuar, zbatuar dhe se do të përditësojë në vijim të gjitha masat e marra, me qëllim zbulimin dhe parandalimin e hapjes së llogarive të shumëfishta nga klientët e saj, duke përfshirë, por pa u kufizuar në përdorimin e *software-ëve* algoritmikë të tregtimit *(Trading Bots);*

d) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit mbështetës, se është në përputhje me kriteret e veçanta teknologjike të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, me qëllim që të mundësojë dhe të mbajë në vazhdimësi një funksionim të përshtatshëm të bursës DLT, si dhe të sigurojë mbrojtjen e interesave të klientëve të saj;

dh) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit përkatës, që ka miratuar, zbatuar dhe se do të përditësojë në vijim rregullat dhe sistemet e brendshme të funksionimit, me qëllim që të

garantojë ndarjen e veprimtarisë së bursës DLT nga veprimtaritë e tjera të tij;

e) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit përkatës, që ka miratuar, zbatuar dhe se do të përditësojë në vijim rregullat e brendshme të funksionimit në lidhje me ngritjen dhe integrimin brenda sistemit të tij të brendshëm të kontrollit, një funksion eficient kontrolli, të pavarur nga funksionet e tregtimit të bursës DLT, nëpërmjet së cilit do të kryhet pa ndërprerje regjistrimi dhe vlerësimi sistematik i të gjitha të dhënave të aktiviteteve tregtare;

ë) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit përkatës, që ka miratuar, zbatuar dhe se do të përditësojë në vijim të gjitha masat e nevojshme për të mbajtur një regjistër kronologjik të të gjithë urdhrave dhe transaksioneve të kryera në bursën DLT, si dhe të sigurojë që çdo ndryshim i të dhënave të mësipërme, duke përfshirë këtu statusin përpara këtyre ndryshimeve, të jetë i gjurmueshëm, edhe në rastet kur ka aktivitet tregtimi intensiv;

f) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit përkatës, që ka miratuar, zbatuar dhe se do të përditësojë në vijim rregulla dhe procedura transparente për tregti të ndershme, eficiente dhe të rregullt, si dhe kritere objektive për ekzekutimin efektiv të urdhrave, të cilat do t'u komunikohen pjesëmarrësve.

2. Vlerësimi i kritereve të veçanta të listuara në shkronjat "a", "b", "c", "ç" dhe "d" do të kryhet nga AKSHI, ndërsa vlerësimi i kritereve të veçanta të listuara në shkronjat "dh", "e", "ë" dhe "f" do të kryhet bashkërisht nga të dyja autoritetet përgjegjëse.

3. Subjekti kërkues për licencë burse DLT ose, sipas rastit, bursa DLT e licencuar, duhet të përmbushë gjithashtu çdo detyrim shtesë që mund të lindë si rrjedhojë e akteve nënligjore të nxjerra në vazhdimësi/në të ardhmen. Aktet nënligjore rregullatore respektive për secilin autoritet përgjegjës, në zbatim të këtij ligji, të cilat ndikojnë në veprimtarinë dhe/ose kushtet dhe kriteret e licencimit të bursave DLT, të cilat janë licencuar përpara hyrjes në fuqi të këtyre akteve, do të shtrijnë efektin te këto bursa DLT vetëm 15 ditë pune pas hyrjes në fuqi të tyre. AMF-ja, sipas rastit, mund të përcaktojë një afat më të shkurtër kohor, por në asnjë rast, më të shkurtër se 10 ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore.

4. Subjekteve kërkuese, të cilat, në momentin e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore, kanë paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë burse DLT, do t'u jepet, në rast të një kërkese nga ana tyre, një kohë shtesë për të qënë në përputhje me këto akte.

Neni 52

**Konflikti i interesit i bursës DLT**

Për çdo token digjital/monedhë virtuale që do të listohet në një bursë DLT, kjo e fundit duhet të deklarojë se është e pavarur nga emetuesi i tokenëve digjitalë/monedhave virtuale dhe se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me emetuesin në fjalë dhe/ose me STO-në ose ICO-n përkatëse. Ky vetëdeklarim duhet t'i bashkëlidhet aplikimit për licencim dhe deklaratës vjetore të përputhshmërisë në vijim.

Neni 53

**Detyrat e bursës DLT**

1. Bursa DLT:

a) në asnjë rrethanë nuk mund të transferojë ose të bllokojë asetet e klientëve, pa marrë udhëzimin e këtyre të fundit me shkrim ose elektronikisht;

b) ndërmerr të gjitha përpjekjet e arsyeshme për t'u shpjeguar klientëve strukturën e tarifave, si dhe i informon ata në mënyrë të përshtatshme për të gjitha tarifat në ngarkim të tyre;

c) bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse; ç) bashkëpunon me agjentin TD të emëruar;

d) mundëson një komunikim të shpejtë dhe efektiv me autoritetet përgjegjëse lidhur me çdo kërkesë të paraqitur nga këta të fundit, në përputhje me këtë ligj;

dh) dorëzon të gjithë dokumentacionin, informacionin e sqarimet e kërkuara nga autoritetet përgjegjëse, sipas formës dhe afateve të përcaktuara në këtë ligj;

e) vendos në dijeni autoritetet përgjegjëse për çdo informacion lidhur me papajtueshmërinë e mundshme të tij me dispozitat e këtij ligji;

ë) njofton me shkrim ose elektronikisht autoritetet përgjegjëse në rast të dorëheqjes ose të ndërprerjes së emërimit të agjentit TD brenda 10 ditëve punë nga data e dorëheqjes ose e ndërprerjes, duke parashtruar arsyet përkatëse të lidhura me dorëheqjen ose ndërprerjen e marrëdhënies;

f) dorëzon pranë autoriteteve përgjegjëse deklaratën e përputhshmërisë së titullarit të licencës:

i. 12 muaj pas datës së regjistrimit të titullarit të licencës në regjistrin përkatës; dhe

ii. çdo muaj të 12-të të mëpasshëm, në përputhje me nenin 17, të këtij ligji;

g) trajton çdo kërkesë tjetër të autoriteteve përgjegjëse dhe/ose çdo autoriteti tjetër shtetëror, në

përputhje me këtë ligj;

gj) i kërkon agjentit të emëruar TD çdo sqarim të nevojshëm lidhur me shqyrtimin e kërkesave për listimin e tregtimin e tokenëve digjitalë dhe/ose monedhave virtuale;

h) shqyrton në mënyrë tërësore çdo kërkesë për listim, tregtim e kryerje transaksionesh me token digjital/monedha virtuale, me qëllim verifikimin e pajtueshmërisë së këtyre të fundit me kërkesat e këtij ligji lidhur me autorizimet e nevojshme nga AMF-ja dhe/ose AKSHI. Çdo token digjital/monedhë virtuale e emetuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji do të shqyrtohet në mënyrë prapaveepruese nga autoriteti përgjegjës, në përputhje me përcaktimet e këtij neni. Tokenët digjitalë të titujve mund të tregtohen e të jenë subjekt i transaksioneve në një bursë DLT të licencuar në Shqipëri vetëm nëse në legjislacionin përkatës të zbatueshëm, interesat e investitorëve nuk janë më pak të mbrojtur se në këtë ligj;

i) zyrtari i pajtueshmërisë dhe/ose çdo drejtues i lartë i bursës DLT miraton, zbaton dhe përditëson në vijim rregulloret e brendshme lidhur me kriteret e vlerësimit që do të përdoren për miratimin e listimit, tregtimit dhe kryerjes së transaksioneve me token digjital/monedha virtuale, si dhe standardet për shqyrtimin e vlerësimin në vazhdimësi të përmbushjes së kushteve për tregtimin e tokenit digjital/monedhës virtuale në bursën DLT përkatëse. Rregulloret e brendshme duhet të përmbajnë minimalisht elementet e mëposhtme:

i. një shqyrtim mujor të dobishmërisë aktuale të tokenit digjital/monedhës virtuale, bazuar në prospektin e plotë/aktofertën/relacionin prezantues, si dhe në çdo informacion ose dokumentacion të vënë në dispozicion nga agjenti TD. Në rastet kur, si rezultat i këtij shqyrtimi, konstatohet se:

- kur një tokeni digjital, të klasifikuar më parë si token digjital shërbimesh/token digjital i pagesave/token digjital i aseteve ose kur një monedhë virtuale ka përvetësuar funksionet dhe karakteristikat e një tokeni digjital të titujve;

- bursës DLT nuk i është vënë në dispozicion licenca e kategorisë “C”, atëherë bursa DLT ndërmerr menjëherë të gjitha masat e nevojshme për çlistimin e këtij/kësaj tokeni digjital/monedhe virtuale;

ii. një shqyrtim mujor të çdo aktiviteti promocional të publikuar në median e shkruar, vizive dhe atë *on-line* (duke përfshirë këtu rrjetet sociale, si dhe çdo deklaratë në vijim) të emetuesit e tokenit digjital/monedhës virtuale ose nga agjentët e tyre TD;

iii. një opinion të përditësuar me shkrim ose elektronikisht të përgatitur nga agjenti DT që sqaron e shpjegon natyrën e tokenit digjital/monedhës virtuale;

j) Publikon informacion mbi tregtimin dhe sigurohet se çdo informacion të vihet në dispozicion të publikut dhe autoriteteve;

k) në rastin e bursës DLT mbajtëse të kategorisë së licencës A dhe B, të sigurohet se klienti ka deklaruar me shkrim se i kupton të gjitha rreziqet e tregtimit në këtë bursë, si edhe se mund të humbasë pjesërisht apo tërësisht kapitalin e vet;

l) në rastin e bursës DLT, mbajtëse të kategorisë së licencës C, të kryejë një vlerësim paraprak të njohurive dhe përshtatshmërisë së klientëve, sipas përcaktimeve të seksionit II, të kreut IV, të ligjit “Për tregjet e kapitalit.

2. Çdo komunikim i ndërsjellë midis bursës DLT dhe autoriteteve përgjegjëse, në përputhje me këtë ligj, do të trajtohet në mënyrë konfidenciale nga bursa DLT e do të ruhet si sekret profesional.

3. Tokenët digjitalë që nuk përfshihen në përkufizimin e tokenëve digjitalë të titujve dhe të cilët janë emetuar jashtë Shqipërisë, do të përjashtohen nga zbatimi i dispozitave të këtij neni.

Neni 54

**Përgjegjësia e bursës DLT**

Bursa DLT mban përgjegjësi ligjore kundrejt çdo klienti për të gjitha dëmet që janë shkaktuar drejtpërdrejt, si rrjedhojë e shkeljes së ndonjërës prej detyrave ose përgjegjësive të saj të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 55

**Kriteret e veçanta të bursës DLT të centralizuar**

1. Subjekti kërkues për licencë për bursë e DLT, e cila do të jetë një bursë DLT e centralizuar duhet të vërtetojë, duke vënë në dispozicion dokumentacionin provues, se ka miratuar dhe ka ndërmarrë të gjitha masat e sigurisë së mëposhtme lidhur me ngritjen e një sistemi të brendshëm të qëndrueshëm, të aftë për të parandaluar e përballuar sulme kibernetike, si dhe për t'u ofruar klientëve një mjet rekursi në rast të humbjes së fondeve:

a) identifikimi me dy faktorë i përdoruesve;
b) *Whitelisting* i adresave të IP-së së përdoruesve;
c) përdorimi i *“off-line storages”;*

ç) përdorimi i portofolave digjitalë me shumë nënshkrime;
d) kryerjen e testeve periodike për të verifikuar qëndrueshmërinë e sistemit;
dh) kryerjen e testeve periodike të penetrimit për të verifikuar sigurinë kibernetike të sistemit;
e) kryerjen e minimalisht një auditimi vjetor, me qëllim vlerësimin e mirëmbajtjes dhe eficiencës së masave të sigurisë, listuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, të këtij neni;
ë) masa për të siguruare garantuar në mënyrë të përshtatshme ndarjen e fondeve të përdoruesve nga fondet e vetë bursës DLT, nëpërmjet krijimit të adresave të veçanta të portofolave.
2. Vlerësimi i kritereve të veçanta të listuara në këtë nen kryhet nga AKSHI.

Neni 56
**Shërbimet e ruajtjes dhe kujdestarisë së bursës DLT të centralizuar**

Në rast se një bursë DLT-je e centralizuar kërkon të ushtrojë veprimtari të lidhura me titujt e transferueshëm, ajo duhet:
a) të marrë një licencë përkatëse nga Banka e Shqipërisë; ose
b) të kontraktojë shërbimet e ruajtjes dhe kujdestarisë së titujve të transferueshëm nga një ofrues i kujdestarisë së portofolave të palëve të treta, i licencuar në përputhje me këtë ligj.

Neni 57
**Kriteret e veçanta për bursat DLT të kategorisë “A”**

1. Krahas kërkesave të veçanta të përcaktuara në nenin 51, një bursë DLT, që aplikon për të marrë licencën e kategorisë “A”, duhet të ketë e të mbajë në vazhdimësi një kapital minimal në vlerën e 20.000.000 (njëzet milionë) lekëve.
2. Vlerësimi i këtij kriteri të veçantë kryhet nga AMF-ja.

Neni 58
**Kriteret e veçanta për bursat DLT të kategorisë “B”**

1. Krahas kërkesave të veçanta të përcaktuara në nenin 51, një bursë DLT, që aplikon për të marrë licencën e kategorisë “B”, duhet:
a) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit përkatës, që do të ketë e do të mbajë në vazhdimësi një kapital minimal në vlerën e 60.000.000 (gjashtëdhjetë milionë) lekëve; ose
b) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit provues, se shuma e parave FIAT të depozituara në bursën DLT nuk duhet të tejkalojë në asnjë kohë vlerën totale prej 30.000.000 (tridhjetë milionë) lekësh.
2. Vlerësimi i kritereve të lartpërmendura kryhet nga AMF-ja.

Neni 59
**Kriteret e veçanta për bursat DLT të kategorisë “C”**

1. Krahas kritereve të veçanta të përcaktuara në nenin 51, një bursë DLT që aplikon për të marrë licencën e kategorisë “C”, duhet:
a) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit përkatës, që do të ketë dhe do të mbajë në vazhdimësi një kapital minimal në vlerën e 90.000. 000 (nëntëdhjetë milionë) lekëve;
b) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit përkatës, që do të ketë e do të mbajë në vazhdimësi një vlerë minimale 1.00 (një) të treguesit të likuiditetit, në përputhje me rregulloret përkatëse të nxjerra nga AMF-ja;
c) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit përkatës, që do të miratojë, zbatojë, mbajë dhe përditësojë në vijim sisteme efektive dhe rregulla të brendshme të funksionimit, për të monitoruar e zbuluar praktikat e abuzimit të tregut, dhe duhet të vërtetojë se rregullat e brendshme përkatëse duhet të përmbajnë minimalisht elementet e mëposhtme:
i. identifikimin dhe vlerësimin gamës së plotë të zonave të lidhura me riskun e manipulimit të tregut dhe të ngjashme;
ii. procedura dhe kontrolle efektive për t’u mbrojtur nga risqet e identifikuara;
iii. caktimin e detyrave e të përgjegjësive për monitorimin e riskut; dhe
iv. një vlerësim periodik e rishikim të procedurave, kontrolleve dhe mekanizmave monitorues, për të garantuar eficiencë të vazhdueshme, duke përfshirë këtu pajtueshmërinë me të gjitha ligjet e rregulloret në fuqi;

ç) pas konstatimit të sjelljes manipuluese, të dorëzojë një raport pranë autoriteteve përgjegjëse (AMF-së dhe AKSHI-t), që tregon të gjitha detajet përkatëse të njohura në kohën e raportit, si dhe një deklaratë të veprimeve të ndërmarra ose të propozuara të merren në lidhje me sjelljen manipuluese.

2. Vlerësimi i kritereve të veçanta të listuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të këtij neni, kryhet nga AMF-ja.

3. Vlerësimi i kriterit të veçantë të listuar në shkronjën “ç” kryhet bashkërisht nga të dyja autoritetet përgjegjëse.

4. Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe deri në mbarimin e muajit të 12-të, autoritetet përgjegjëse kufizojnë dhënien e bursës DLT me licencë “C”, me qëllim monitorimin e veprimtarisë së titullarëve të licencës për periudhën fillestare.

5. Për qëllime të zbatimit të pikës 4, të këtij neni, autoritetet përgjegjëse përcaktojnë kriteret, procedurat dhe modalitetet, lidhur me kufizimin për dhënien e bursës DLT me licencë “C” nga autoritetet përgjegjëse.

Neni 60

**Veprimtaria e *Margin Trading***

Një bursë DLT mund të kryejë veprimtaritë të lidhura me *Margin Trading* vetëm në rastet kur ajo:

a) vërteton, duke vënë në dispozicion një kopje të licencës përkatëse nga Banka e Shqipërisë;

b) vërteton, duke vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit përkatës, që veprimtaria e *Margin Trading* në bursën DLT-së është në përputhje me kushtet e kriteret që përcaktohen nga aktet rregullatore në zbatim të këtij ligji.

Neni 61

**Ambientet e tregtimit DLT**

1. Çdo ambient tregtimi mund ushtrojë gjithashtu veprimtaritë tregtare të një burse DLT dhe, gjatë ushtrimit të këtyre veprimtarive, konsiderohet si një vend tregtimi DLT, në kuptim të këtij ligji, pas certifikimit nga ana e AKSHI-t të kritereve të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të nenit 51, të këtij ligji. Certifikimi nga AKSHI kryhet në përputhje me dispozitat e kreut II, të këtij ligji, duke zbatuar në mënyrë analoge procedurat përkatëse.

2. Krahas parashikimeve në pikën 1, të këtij neni, dispozitat e këtij kreu, zbatohen në mënyrë analoge edhe për ambientet e tregtimit DLT, krahas dispozitave përkatëse të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

KREU VI

OFRUESIT E SHËRBIMEVE INOVATIVE DHE
MARRËVESHJET E TEKNOLOGJISË INOVATIVE

SEKSIONI I

OFRUESIT E SHËRBIMEVE INOVATIVE

Neni 62

**Dispozita të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve inovative**

1. Çdo person juridik që dëshiron të ushtrojë veprimtarinë si ofrues i shërbimeve inovative, në përputhje me këtë ligj, duhet të disponojë licencën përkatëse të lëshuar nga AKSHI, si dhe të jetë i regjistruar në regjistrin e ofruesve të shërbimeve inovative, sipas përcaktimeve të nenit 25, të këtij ligji.

2. Shërbimet dhe aktivitetet e përcaktuara për ofruesit e shërbimeve inovative mund të kryhen vetëm nga ata ofrues të shërbimeve inovative, të cilët disponojnë licencën përkatëse dhe vetëm gjatë periudhës së vlefshmërisë së kësaj licence.

Neni 63

**Kriteret e veçanta për ofruesit e shërbimeve inovative**

1. Krahas kushteve të përgjithshme të parashikuara në nenin 9, të kreut II, të këtij ligji, subjekti kërkues për licencë si ofrues i shërbimeve inovative (si dhe ofruesi i shërbimeve inovative i licencuar), në përputhje me këtë ligj, duhet të vërtetojë, duke i bashkëlidhur aplikimit të tij për licencim dokumentacionin

përkatës që vërteton se zotëron njohuritë dhe aftësitë e duhura teknike për të ushtruar veprimtarinë e lidhur me ofruesit e shërbimeve inovative.

2. Vlerësimi i këtij kriteri të veçantë së bashku me dokumentacionin përkatës kryhet nga AKSHI.

3. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar e tij.

4. Me qëllim garantimin e një niveli të përshtatshëm profesionalizmi, subjekti kërkues për licencë si ofruesi i shërbimeve inovative, ose, sipas rastit, ofruesi i shërbimeve inovative i licencuar, duhet të vërtetojë se ka kryer e do të vazhdojë të kryejë rregullisht programe të detyrueshme trajnimi. Programet e trajnimit të detyrueshëm përcaktohen nga aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

5. Subjekti kërkues për licencë si ofrues i shërbimeve inovative ose, sipas rastit, ofruesi i shërbimeve inovative i licencuar duhet të përmbushë gjithashtu çdo detyrim shtesë që mund të lindë si rrjedhojë e akteve nënligjore të nxjerra në të ardhmen.

6. Aktet nënligjore të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij ligji, të cilat ndikojnë në veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve inovative të licencuar përpara hyrjes në fuqi të këtyre akteve, shtrijnë efektin te këta ofrues të shërbimeve inovative vetëm 15 dite pune pas hyrjes në fuqi të tyre. AKSHI, sipas rastit, mund të përcaktojë një afat më të shkurtër kohor, por jo më të shkurtër se 10 ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore.

7. E njëjta dispozitë zbatohet edhe për subjektet kërkuese, të cilat kanë paraqitur kërkesën për t'u licencuar si ofrues të shërbimeve inovative përpara hyrjes në fuqi të akteve nënligjore. Në këtë rast, subjekti kërkues mund të kërkojë pezullimin e procedurës së licencimit për periudhën e përmendur në pikën 6, të këtij neni.

8. Për të ruajtur licencën e ofruesit të shërbimeve inovative, ky i fundit duhet të dorëzojë pranë AKSHI-t një vetëdeklarim, i cili duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

a) të vërtetojë që ofruesi i shërbimeve inovative plotëson të gjitha kushtet e përgjithshme e kriteret e veçanta dhe është në përputhje me të gjitha detyrimet e përcaktuara në këtë ligj; dhe

b) të informojë AKSHI-n për çdo ndryshim në strukturën menaxhuese të ofruesit të shërbimeve inovative, konkretisht, ndryshimet lidhur me drejtorët, administratorët ose personelin kyç, si dhe ndryshime në rregullat e brendshme të funksionimit të ofruesit të shërbimeve inovative.

9. Brenda muajit janar të çdo viti, ofruesi i shërbimeve inovative është i detyruar të dorëzojë pranë AKSHI-t dokumentacionin provues lidhur me kryerjen e programit të detyrueshëm të trajnimit të vazhdueshëm, me qëllim që t'i mundësojë AKSHI-t të vlerësojë nëse ofruesi i shërbimeve inovative vazhdon të ketë aftësitë e njohuritë e duhura teknike dhe ligjore për të ushtruar veprimtarinë për të cilën është licencuar.

Neni 64

**Konflikti i interesave të ofruesve të shërbimeve inovative**

1. Për çdo kërkesë të lidhur me certifikimin e marrëveshjeve të teknologjisë inovative, ofruesi i shërbimeve inovative duhet t'i bashkëlidhë kërkesës përkatëse edhe një vetëdeklarim të tijin, ku shprehet se ky i fundit është i pavarur nga subjekti kërkues dhe nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me të ose me marrëveshjen e teknologjisë inovative përkatëse.

2. Ofruesi i shërbimeve inovative duhet të vijojë të mbetet i pavarur dhe të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e certifikuar edhe pas marrjes së certifikimit nga ky i fundit. Për këtë arsye, vetëdeklarimi i mësipërm duhet të vijojë t'i bashkëlidhet edhe deklaratës vjetore të përputhshmërisë së titullarit të licencës.

Neni 65

**Detyrimet e ofruesit të shërbimit inovativ**

1. Ofruesi i shërbimeve inovative duhet:

a) të ndihmojë subjektin kërkues për kryerjen e të gjitha procedurave të lidhura me certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative, si dhe të ofrojë shërbime të tjera që konsiderohen si të nevojshme e të përshtatshme, në përputhje me këtë ligj;

b) të ndihmojë subjektin e certifikuar pas procedurave të certifikimit të marrëveshjes së teknologjisë inovative në të gjitha çështjet që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së këtij të fundit, me qëllim mbajtjen në vazhdimësi të certifikimit përkatës, konkretisht, duke ofruar shërbimet e teknologjisë inovative, si: auditimi dhe shqyrtimi i marrëveshjes së teknologjisë inovative dhe stafit teknik, si dhe të ofrojë shërbime të tjera që konsiderohen si të nevojshme ose të përshtatshme në përputhje me këtë ligj;

c) të ndihmojë subjektin kërkues për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative në përmbushjen e të gjitha detyrave e përgjegjësive që rrjedhin nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

ç) të veprojë gjithnjë në mënyrë bashkëpunuese dhe në marrëdhënien me AKSHI-n;

d) të bashkëpunojë me agjentët DT në lidhje me hartimin e deklaratës së përputhshmërisë së titullarëve të licencës, në rast të delegimit të kompetencave specifike nga agjenti DT tek ofruesi i shërbimit inovativ, sipas përcaktimeve të kreut IV, të këtij ligji;

dh) të mundësojë një komunikim të shpejtë dhe efektiv ndërmjet subjekteve kërkuese për certifikimin e marrëveshjes inovative të teknologjisë dhe AKSHI-t, në lidhje me çdo kërkesë të paraqitur nga AKSHI, gjatë ose pas procedurës së certifikimit, në përputhje me këtë ligj;

e) të dorëzojë, në emër dhe për llogari të subjektit kërkues, për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative ose subjektit të certifikuar, të gjithë dokumentacionin, informacionin e sqarimet e kërkuara nga AKSHI, brenda formës dhe afateve të përcaktuara në këtë ligj;

ë) të vendosë menjëherë në dijeni AKSHI-n për çdo informacion në lidhje me papajtueshmërinë e mundshme të subjektit kërkues për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative të subjektit të certifikuar, me dispozitat e këtij ligji;

f) të njoftojë me shkrim ose elektronikisht AKSHI-n në rast të dorëheqjes ose të ndërprerjes së emërimit të tij si ofrues i shërbimeve inovative brenda 5 ditëve pune nga data e dorëheqjes ose ndërprerjes së emërimit, duke parashtruar arsyet përkatëse të lidhura me dorëheqjen ose ndërprerjen e emërimit të tij;

g) të dorëzojë pranë AKSHI-t deklaratën e përputhshmërisë së marrëveshjes së teknologjisë inovative:

i. 12 muaj pas datës së regjistrimit të certifikatës së marrëveshjes së inovacionit teknologjik në regjistrin përkatës; dhe

ii. çdo muaj të 12-të të mëpasshëm, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

gj) të trajtojë çdo kërkesë tjetër të AKSHI-t dhe/ose të çdo autoriteti tjetër shtetëror, në përputhje me këtë ligj.

2. Çdo komunikim i ndërsjellë ndërmjet ofruesit të shërbimeve inovative dhe autoriteteve përgjegjëse, në përputhje me këtë ligj, trajtohet në mënyrë konfidenciale nga ana e ofruesit të shërbimeve inovative e ruhet si sekret profesional.

Neni 66

**Detyrat e posaçme të njoftimit nga ofruesit e shërbimeve inovative**

1. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së përcaktuar në shkronjën “b”, të nenit 65, të këtij ligji, ofruesi i shërbimeve inovative duhet të njoftojë AKSHI-n brenda 15 ditëve punë nga momenti i konstatimit të një ose më shumë rrethanave të mëposhtme:

a) çdo ndryshim të konfigurimeve të *software-it* të marrëveshjes së teknologjisë inovative;

b) çdo zhvillim që ndikon në mënyrë të konsiderueshme të drejtat e përdoruesve;

c) çdo zhvillim që ndikon në mënyrë të konsiderueshme të drejtat, certifikimin dhe kompetencat e ofruesve të shërbimeve inovative në ofrimin e shërbimeve si administrator teknik;

ç)çdo ndryshim ose zhvillim që mund të ndikojë në garancitë ndaj përdoruesve lidhur me sigurinë kibernetike.

2. Brenda 5 ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit, AKSHI do të nisë një procedurë verifikimi të limituar vetëm në informacionin e përmbajtur në njoftimin përkatës, e cila do të jetë analoge me atë të trajtimit të një kërkese të re për certifikim e do të vendosë lidhur me:

a) miratimin e ndryshimeve dhe/ose zhvillimeve të përcaktuara në njoftimin përkatës;

b) refuzimin e ndryshimeve ose të zhvillimeve të përcaktuara në njoftimin përkatës, duke arsyetuar bazat e një vendimi të tillë. Në rast të refuzimit të ndryshimeve dhe/ose zhvillimeve përkatëse, certifikata e marrëveshjes së teknologjisë inovative konsiderohet automatikisht e tërhequr. Në një rast të tillë, të gjitha dispozitat përkatëse të këtij ligji zbatohen në mënyrë analoge.

Neni 67

**Përgjegjësia e ofruesit të shërbimit inovativ**

Ofruesi i shërbimeve inovative mbajnë përgjegjësi ligjore kundrejt çdo subjekti kërkues për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative ose çdo subjekti të certifikuar për të gjitha dëmet e shkaktuara, si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e shkeljes së ndonjërës prej detyrave ose përgjegjësive të ofruesit të shërbimeve inovative të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 68

**Delegimi te palët e treta**

1. Duke marrë parasysh, por pa u kufizuar në aspektet rregullatore dhe ato të përputhshmërisë ligjore të hartimit të deklaratës vjetore të përputhshmërisë, ofruesi i shërbimeve inovative mund të delegojë një ose më shumë nga veprimtaritë e lartpërmendura te një palë e tretë, me kusht që kjo e fundit të zotërojë të gjitha njohuritë, aftësitë dhe kërkesat organizative të nevojshme për kryerjen e veprimtarive të deleguara.

2. Në rast të delegimit te palë të treta të veprimtarive të përmendura më lart, ofruesi i shërbimit inovativ mbajnë përgjegjësi direkte për të gjitha detyrat e përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj.

SEKSIONI II
MARRËVESHJET E TEKNOLOGJISË INOVATIVE

Neni 69
**Detyrimet e subjektit kërkues për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative**

1. Subjekti kërkues, për marrjen e një certifikate të marrëveshjes së teknologjisë inovative, duhet:

a) të ushtrojë veprimtarinë e tij me ndershmëri dhe integritet, duke u kushtuar vëmendjen e duhur interesave dhe nevojave të gjithsecilit prej përdoruesve të tij;

b) të ushtrojë veprimtarinë e tij me aftësinë, përkujdesjen e vigjilencën e duhur, duke i trajtuar përdoruesit e tij në një mënyrë të drejtë, të pastër dhe të ndershme;

c) të mbajë nivelin e sigurisë dhe protokollet e aksesit të sistemit të tij në standardet më të larta të përshtatshme;

ç)të ngrejë, vetë ose nëpërmjet një pale të tretë, sisteme për parandalimin, zbulimin, eliminimin dhe identifikimin e risqeve të krimit financiar, si dhe pastrimit të parave e financimit të terrorizmit;

d) të ketë burime financiare të mjaftueshme.

2. Vlerësimi i kritereve të lartpërmendura kryhet nga ofruesi i shërbimeve inovative, i cili duhet të dorëzojë pranë AKSHI-t dhe t'i bashkëlidhë kërkesës për certifikim edhe një vetëdeklarim në lidhje me përmbushjen e këtyre kritereve nga ana e subjektit kërkues.

Neni 70
**Kushtet e marrëveshjes së teknologjisë inovative**

Përdorimi i marrëveshjeve të teknologjisë inovative certifikohet vetëm në rastet kur subjekti kërkues:

a) ka emëruar një ofrues të shërbimeve inovative, i cili kryen detyrat e parashikuara në këtë krye;

b) ka hartuar, nëpërmjet ofruesit të shërbimeve inovative të emëruar, raportin teknik në lidhje me marrëveshjen e teknologjisë inovative. Mënyra e hartimit dhe përmbajtja e raportit teknik përcaktohen me akte nënligjore ose rregullatore të autoriteteve përgjegjëse, të cilat duhet të jetë në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

c) dorëzon tek AKSHI, nëpërmjet ofruesit të shërbimit inovativ të emëruar, kërkesën për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative, duke i bashkëlidhur raportin teknik dhe vetëdeklarimin e ofruesit të shërbimit inovativ, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 71
**Kërkesa për certifikim**

1. Subjekti kërkues për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative duhet të përgatisë dhe të dorëzojë kërkesën përkatëse, nëpërmjet ofruesit të shërbimit inovativ të emëruar, pranë AKSHI-t. Kërkesa për certifikim dhe dokumentacioni provues mund të dorëzohet në formë elektronike, sipas përcaktimeve të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, të cilat mund të parashikojnë aplikimin e teknologjisë së regjistrave të shpërndarë.

2. Dokumentacioni provues i kërkesës për certifikim duhet të përfshijë:

a) raportin teknik, sipas përcaktimeve të nenit 70, të këtij ligji;

b) vetëdeklarimin e ofruesit të shërbimit inovativ, sipas përcaktimeve të nenit 70, të këtij ligji;

c) mandatin e pagesës së tarifës së procedurave të aplikimit për marrëveshjen e teknologjisë inovative.

Neni 72
**Afatet e procedurës së certifikimit**

AKSHI shqyrton kërkesën për certifikim së bashku me dokumentacionin provues dhe vendos për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative brenda 15 ditëve pune nga dorëzimi i kërkesës së lartpërmendur, në përputhje me nenin 71, të këtij ligji.

Neni 73
**Kompetencat e AKSHI-t**

1. Krahas kompetencave të tjera që i janë dhënë AKSHI-t në këtë ligj, ky i fundit ushtron edhe kompetencat e mëposhtme në lidhje me certifikimin e marrëveshjeve të teknologjisë inovative:

AKSHI mund të kërkojë:

a) sqarime të mëtejshme dhe/ose përfshirjen e informacioneve plotësuese në raportin teknik brenda 15 ditëve punë nga data e dorëzimit të kërkesës për certifikim;

b) kryerjen e ndryshimeve në përmbajtjen e marrëveshjes së teknologjisë inovative, brenda 15 ditëve punë nga data e dorëzimit të kërkesës për certifikim, me qëllim sjelljen e marrëveshjes së teknologjisë inovative brenda parametrave të këtij ligji.

2. Kërkesat e AKSHI-t për sqarime të mëtejshme dhe/ose përfshirjen e informacionit plotësues dhe/ose kryerjen e ndryshimeve në përmbajtjen e marrëveshjes së teknologjisë inovative duhet të jenë të argumentuara në mënyrë të arsyeshme, duke pasur qëllim garantimin e mbrojtjen e të drejtave të blerësve të tokenëve digjitalë/monedhave virtuale.

3. Në rastet e ndonjërës prej kërkesave të mësipërme, afati 15-ditor, i përcaktuar në nenin 72, pezullohet deri në momentin kur subjekti kërkues dorëzon pranë AKSHI-t, nëpërmjet ofruesit të shërbimeve inovative, sqarimet e mëtejshme dhe/ose përfshin informacionin plotësues dhe/ose kryen ndryshimet e kërkuara në përmbajtjen e marrëveshjes së teknologjisë inovative.

4. Nëse subjekti kërkues nuk arrin të sigurojë sqarimet e mëtejshme dhe/ose të përfshijë informacionin plotësues dhe/ose të kryejë ndryshimet e kërkuara në përmbajtjen e marrëveshjes së teknologjisë inovative, brenda 10 ditëve punë (ose kur në varësi të rrethanave, AKSHI përcakton një afat më të gjatë, por jo më shumë se 20 ditë pune), kërkesa për certifikim konsiderohet e refuzuar në mënyrë automatike.

5. Me qëllim shqyrtimin tërësor të sqarimeve të mëtejshme dhe/ose përfshirjes së informacionit plotësues dhe/ose kryerjes së ndryshimeve të kërkuara në përmbajtjen e marrëveshjes së teknologjisë inovative, të dorëzuara nga subjekti kërkues, nëpërmjet ofruesit të shërbimeve inovative, përllogaritja e ditëve të mbetura nga afati 15-ditor, i përcaktuar në nenin 72, rifillon vetëm 3 ditë pune pas marrjes në dorëzim të sqarimeve dhe/ose dokumentacionit plotësues dhe/ose të dokumentacionit provues të kryerjes së ndryshimeve të kërkuara në përmbajtjen e marrëveshjes së teknologjisë inovative.

6. Pas përfundimit të procedurave të certifikimit të marrëveshjes së teknologjisë inovative, AKSHI mund:

a) të pezullojë veprimtarinë e marrëveshjes së teknologjisë inovative, nëse AKSHI dyshon, mbi baza të arsyeshme, se është shkelur një ose më shumë nga dispozitat e këtij ligji. Në këtë rast, vendimi për pezullimin e veprimtarisë së marrëveshjes së teknologjisë inovative publikohet nga AKSHI brenda 3 ditëve punë, duke i lënë subjektit një afat prej 10 ditësh punë për të dorëzuar pranë AKSHI-t qëndrimet e tij në lidhje me vendimin e pezullimit, së bashku me dokumentacionin provues, sipas kërkesës së AKSHI-t. Në rast të përgjigjes së subjektit brenda afatit të mësipërm, AKSHI shqyrton parashtrimet e dorëzuara prej tij së bashku me dokumentacionin provues dhe vendos në lidhje me miratimin e vijimit të veprimtarisë së marrëveshjes së teknologjisë inovative të pezulluar ose tërheqjen e certifikatës;

b) të tërheqë në mënyrë të menjëhershme certifikatën e marrëveshjes së teknologjisë inovative pa iu nënshtruar fillimisht procedurave të pezullimit, në rast se AKSHI ka në dispozicion prova që vërtetojnë se janë shkelur dispozitat e këtij ligji. Në këtë rast, vendimi për tërheqjen e certifikatës së marrëveshjes teknologjike publikohet nga AKSHI brenda 3 ditëve punë nga momenti i marrjes së vendimit të shkeljes/ve.

7. Si gjatë procedurës së certifikimit të marrëveshjes së teknologjisë inovative, ashtu dhe pas certifikimit të saj, AKSHI mund të bëjë publik faktin se subjekti kërkues ose, sipas rastit, subjekti i certifikuar nuk arrin të përmbushë detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 74
**Refuzimi i certifikimit**

1. AKSHI refuzon kërkesën për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative në rast të

konstatimit të një prej shkaqeve të mëposhtme:

a) mospagimi i tarifës së aplikimit për t'u certifikuar me marrëveshjen e teknologjisë inovative;

b) dokumentacioni i dorëzuar është i pamjaftueshëm ose jo i plotë;

c) dokumentacioni dhe/ose informacioni i dorëzuar është i rremë dhe/ose i pasaktë;

ç) subjekti kërkues nuk përmbush kriteret për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative;

d) vlerësohet në mënyrë të argumentuar se subjekti kërkues nuk mund të vijojë të plotësojë kushtet dhe kriteret e kërkuara për pajisjen me autorizim.

2. Me vendim të Këshillit të Ministrave, përcaktohet mënyra e vlerësimit të shkaqeve të përcaktuara në shkronjën “d”, të pikës 1, të këtij neni.

Neni 75

**Detyrat e ofruesit të shërbimit inovativ**

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së lidhur me marrëveshjet e teknologjisë inovative, ofruesi i shërbimeve inovative duhet t'u përmbahet rregullave dhe dispozitave të përcaktuara në krerët II e IV, të këtij ligji.

KREU VII

KUJDESTARI PËR PORTOFOLIN E PALËVE TË TRETA

Neni 76

**Dispozitat e përgjithshme për kujdestarët e portofolit të palëve të treta**

1. Çdo person juridik që dëshiron të ushtrojë veprimtarinë si “kujdestar i portofolit të palëve të treta”, në përputhje me këtë ligj, duhet të disponojë:

a) licencën përkatëse nga Banka e Shqipërisë;

b) licencën si kujdestar i portofolave të palëve të treta; dhe

c) regjistrimin në regjistrin e kujdestarëve të portofolave të palëve të treta, në përputhje me nenin 26, të këtij ligji.

2. Shërbimet dhe aktivitetet e përcaktuara për kujdestarët e portofolit të palëve të treta mund të kryhen vetëm nga ata kujdestarë të portofolit të palëve të treta, të cilët disponojnë licencën përkatëse dhe vetëm gjatë periudhës së vlefshmërisë së kësaj licence.

Neni 77

**Kriteret e veçanta të kujdestarit të portofolit të palëve të treta**

1. Krahas kushteve të përgjithshme të parashikuara në nenin 9, të kreut II, të këtij ligji, subjekti kërkues për licencë si kujdestar i portofolave të palëve të treta, në përputhje me këtë ligj, duhet të plotësojë edhe kriteret e veçanta si më poshtë:

a) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion dokumentacionin provues, se ka miratuar dhe ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme të sigurisë në lidhje me ngritjen e një sistemi të brendshëm të qëndrueshëm, të aftë për të parandaluar dhe përballuar sulme kibernetike, si dhe për t’u ofruar klientëve një mjet rekursi në rast të humbjes së fondeve;

b) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit provues që ka miratuar, zbatuar e se do të përditësojë në vijim një program gjithëpërfshirës të menaxhimit të riskut, i cili duhet të përfshijë gjithashtu masat e marra në kuadër të sigurisë kibernetike;

c) të vërtetojë, duke vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit provues se ka miratuar, zbatuar e se do të përditësojë në vijim masat përkatëse për të siguruar dhe garantuar në mënyrë të përshtatshme ndarjen e fondeve të klientëve nga fondet e vetë kujdestarëve të portofolave të palëve të treta;

ç) të vërtetojë, nëpërmjet dokumentacionit provues, që ka një kapital fillestar minimal të kompanisë prej 18.000.000 (tetëmbëdhjetë milionë) lekësh.

2. Vlerësimi i kritereve të veçanta të listuara në shkronjat “a”, “b” e “c” kryhet nga AKSHI, ndërsa vlerësimi i kriterit të veçantë të listuar në shkronjën “ç” kryhet nga AMF-ja.

3. Subjekti kërkues, për t'u pajisur me licencë si kujdestar i portofolit të palëve të treta, përmbush çdo detyrim të përcaktuar nga aktet nënligjore ose rregullatore në zbatimin e këtij neni. Në rast se kërkesa e subjektit kërkues është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të aktit nënligjor ose rregullator, autoriteti përgjegjës njofton kërkuesin për nevojën për plotësimin e aplikimit me kërkesat e reja, duke i lënë për këtë qëllim kohën e nevojshme, por në çdo rast jo më të shkurtër se 10 ditë pune nga e nesërmja e hyrjes në fuqi të aktit nënligjor ose rregullator. Në këtë rast afatet e përcaktuara në nenin 11, të këtij ligji, pezullohen për aq kohë

sa i është lënë në dispozicion aplikuesit për plotësimin e aplikimit.

4. E njëjta dispozitë zbatohet edhe për subjektet kërkuese, të cilat kanë paraqitur kërkesën për licencim si kujdestar i portofolit të palëve të treta përpara hyrjes në fuqi të akteve nënligjore. Në këtë rast, subjekti kërkues mund të kërkojë pezullimin e procedurës së licencimit përgjatë periudhës së lartpërmendur.

5. Për qëllime të pikës 1, shkronja ”a”, të këtij neni, përmes akteve nënligjore rregulluese respektive për secilin autoritet përgjegjës, në zbatim të këtij ligji, përcaktohen llojet, kushtet, kriteret dhe procedurat lidhur me masat minimale të sigurisë, që duhet të implementohen për të parandaluar dhe përballuar sulmet kibernetike, si dhe për të ofruar ndaj klientëve mjetet e rekursit në rast të humbjes së fondeve.

Neni 78

**Detyrat e ofruesit të kujdestarisë për portofolin e palëve të treta**

Ofruesi i shërbimit të kujdestarisë së portofolit për palët e treta:

a) në asnjë rrethanë nuk mund të transferojë ose të bllokojë asetet e klientëve pa marrë udhëzimin e këtyre të fundit me shkrim ose elektronikisht;

b) ndërmerr të gjitha përpjekjet e arsyeshme për t'u shpjeguar klientëve strukturën e tarifave, si dhe i informon ata në mënyrë të përshtatshme për të gjitha tarifat në ngarkim të tyre;

c) pas konstatimit të praktikave abuzive në shkelje të këtij ligji, të hartojë dhe të dorëzojë një raport pranë AMF-së, i cili përmban të gjitha detajet përkatëse të njohura në kohën e raportit, si dhe një deklaratë të veprimeve të ndërmarra ose propozime për veprime që duhet të ndërmerren në kuadër të sjelljes manipulative;

ç) të veprojë gjithnjë në mënyrë bashkëpunuese dhe në marrëdhënien me autoritetet përgjegjëse;

d) të veprojë gjithnjë në mënyrë bashkëpunuese dhe në marrëdhënien me agjentin TD;

dh) të mundësojë një komunikim të shpejtë dhe efektiv me autoritetet përgjegjëse në lidhje me çdo kërkesë të paraqitur nga këto të fundit, në përputhje me këtë ligj;

e) të dorëzojë të gjithë dokumentacionin, informacionin dhe sqarimet e kërkuara nga autoritetet përgjegjëse, sipas formës dhe afateve të përcaktuara në këtë ligj si dhe në aktet nënligjore ose rregullatorë në zbatim të tij;

ë)të informojë autoritetet përgjegjëse për çdo informacion në lidhje me papajtueshmërinë e mundshme të tij me dispozitat e këtij ligji;

f) të njoftojë me shkrim ose elektronikisht autoritetet kompetente në rast të dorëheqjes ose të ndërprerjes së emërimit të agjentit TD brenda 10 ditëve punë nga data e dorëheqjes ose e ndërprerjes se marrëdhënies, duke parashtruar arsyet përkatëse të lidhura me dorëheqjen ose ndërprerjen e marrëdhënies;

g) të dorëzojë pranë autoriteteve përgjegjëse, nëpërmjet agjentit TD, deklaratën e përputhshmërisë së titullarit të licencës:

i. 12 muaj pas datës së regjistrimit të titullarit të licencës në regjistrin përkatës; dhe

ii. çdo muaj të 12-të të mëpasshëm, në përputhje me nenin 17, të këtij ligji;

gj) të trajtojë çdo kërkesë tjetër të autoriteteve përgjegjëse dhe/ose çdo autoriteti tjetër shtetëror, në përputhje me këtë ligj.

Çdo komunikim i ndërsjellë ndërmjet kujdestarit të portofolit të palëve të treta dhe autoriteteve përgjegjëse, në përputhje me këtë ligj, trajtohet nga kujdestari i portofolit të palëve të treta në mënyrë konfidenciale e ruhet si sekret profesional.

Neni 79

**Përgjegjësitë e ofruesit të kujdestarisë të portofolit të palëve të treta**

Ofruesi i shërbimit të kujdestarisë së portofolit të palëve të treta mban përgjegjësi ligjore kundrejt çdo klienti për të gjitha dëmet që janë shkaktuar si rrjedhojë drejtpërdrejtë e shkeljes së ndonjërës prej detyrave ose përgjegjësive të tij të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 80

**Ofruesi i shërbimit jokujdestar të portofolit të palëve të treta**

Ofruesit e shërbimit jokujdestar të portofolave të palëve të treta, të cilët ofrojnë aplikacione për të mbajtur, ruajtur apo transferuar tokenë digjitalë dhe/ose monedha virtuale, por pa përfshirë shërbimin e kujdestarisë, janë subjekt i dispozitave të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”.

## KREU VIII
## SIPËRMARRJET E AUTOMATIZUARA TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE DT

### Neni 81
### **Dispozita të përgjithshme për sipërmarrjet e automatizuara të investimeve kolektive të DT-së**

1. Çdo person juridik ose bashkim asetesh që vepron si sipërmarrje e automatizuar e investimeve kolektive të DT-së, në përputhje me këtë ligj, duhet:

a) të administrohet nga një subjekt i licencuar nga AMF-ja si shoqëri administruese e fondit të investimeve alternative, në përputhje me ligjin për sipërmarrjet e investimeve kolektive; dhe

b) të disponojë licencën si sipërmarrje e automatizuar e investimeve kolektive DT, të lëshuar nga AKSHI; dhe

c) të jetë i regjistruar në regjistrin e sipërmarrjeve të automatizuara të investimeve kolektive, DT, sipas përcaktimeve të nenit 25, të këtij ligji.

2. Shërbimet dhe aktivitetet e përcaktuara për sipërmarrjet e automatizuara të investimeve kolektive DT mund të kryhen vetëm nga ato sipërmarrje të automatizuara të investimeve kolektive DT, të cilat disponojnë licencat përkatëse dhe vetëm gjatë periudhës së vlefshmërisë së këtyre licencave.

3. Sipërmarrjet e automatizuara të investimeve kolektive DT konsiderohen si fonde të investimeve alternative dhe u ofrohen vetëm klientëve profesionistë, sipas përcaktimeve të ligjit “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Sipërmarrjet e paautomatizuara të investimeve kolektive DT konsiderohen si fonde të investimeve alternative dhe rregullohen nga ligji për sipërmarrjet e investimeve kolektive e përjashtohen nga zbatimi i këtij ligji.

### Neni 82
### **Kriteret e veçanta për sipërmarrjet e automatizuara të investimeve kolektive DT**

1. Krahas kushteve të përgjithshme të parashikuara në nenin 9, të kreut II, të këtij ligji, për personin juridik dhe kërkesave të ligjit për sipërmarrjet e investimeve kolektive, subjekti kërkues për licencë, si sipërmarrje e automatizuar e investimeve kolektive DT, duhet të vërtetojë, duke vënë në dispozicion:

a) kopje të vendimit të certifikimit nga AKSHI për marrëveshjen e teknologjisë inovative, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, e cila përfaqëson një sistem të automatizuar robotik që vepron si këshillues investimesh;

b) dokumentacionin provues se sistemi i automatizuar robotik i konsulencës, i cili vepron si këshillues investimesh dhe/ose si një shoqëri administruese e fondeve, garanton qëndrueshmërinë teknologjike të marrëveshjes së teknologjisë inovative të certifikuar;

c) dokumentacionin provues se shërbimet e ruajtjes e kujdestarisë së aseteve të sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive DT do kryhen nga një kujdestar i portofolit të palëve të treta, i licencuar sipas këtij ligji, ku shoqëria që administron sipërmarrjen e automatizuar të investimeve kolektive nuk ka pjesëmarrje influencuese te ky kujdestar;

ç)prospektin e plotë të sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive DT;

d) një kopje të dokumentacioni provues se shoqëria administruese plotëson kërkesat për mjaftueshmëri kapitali, në përputhje me kërkesat e ligjit për sipërmarrjet e investimeve kolektive;

dh) dokumentacionin provues se shërbimet e vlerësimit dhe auditimit të sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive DT do kryhen nga shoqëri që kanë eksperiencë në kryerjen e auditimit të këtyre sipërmarrjeve.

2. Vlerësimi i kriterit të veçantë të listuar në shkronjën “a” kryhet nga AKSHI, ndërsa vlerësimi i kritereve të veçanta të listuara në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” kryhet nga AMF-ja.

3. Subjekti kërkues për licencë si sipërmarrje e automatizuar e investimeve kolektive të DT ose, sipas rastit, sipërmarrja e investimeve kolektive të automatizuara DT e licencuar duhet të përmbushë çdo detyrim shtesë që mund të lindë si rrjedhojë e akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji. Aktet nënligjore rregulluese respektive për secilin autoritet përgjegjës në zbatim të këtij ligji, të cilat ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve të automatizuara të investimeve kolektive DT, që janë licencuar përpara hyrjes në fuqi të këtyre akteve, shtrijnë efektin te këto sipërmarrje të investimeve kolektive të automatizuara DT vetëm 15 ditë pune pas hyrjes në fuqi të tyre.

4. E njëjta dispozitë zbatohet edhe për subjektet kërkuese, të cilat kanë paraqitur kërkesën për për t'u licencuar si sipërmarrje e investimeve kolektive të automatizuara DT përpara hyrjes në fuqi të akteve nënligjore. Në këtë rast, subjekti kërkues mund të kërkojë pezullimin e procedurës së licencimit për periudhën e lartpërmendur.

Neni 83
**_Web-faqja_ e sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive DT**

Përmbajtja specifike dhe formati i *web-faqes* së sipërmarrjes së automatizuar investimeve kolektive DT përcaktohet nga aktet rregullatore të miratuara nga AMF-ja.

Neni 84
**Detyrimet e sipërmarrjeve të automatizuara të investimeve kolektive DT**

1. Sipërmarrjet e investimeve kolektive të automatizuara DT duhet:

a) të garantojnë autoritetet përgjegjëse dhe vazhdimisht të verifikojnë plotësimin e të gjitha kërkesave, detyrave e përgjegjësive të tyre, sipas këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi;

b) të veprojnë gjithmonë në mënyrë bashkëpunuese dhe në marrëdhënien me autoritetet përgjegjëse;

c) të veprojnë gjithmonë në mënyrë bashkëpunuese dhe në marrëdhënien me agjentin e emëruar TD;

ç)të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin, informacionin dhe sqarimet e kërkuara nga autoritetet përgjegjëse, sipas formës dhe afateve të përcaktuara në këtë ligj;

d) të informojnë autoritetet përgjegjëse për çdo informacion në lidhje me papajtueshmërinë e mundshme të sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive DT me dispozitat e këtij ligji;

dh) të njoftojnë me shkrim ose elektronikisht autoritetet përgjegjëse në rast të dorëheqjes ose të ndërprerjes së emërimit të agjentit TD brenda 10 ditëve punë nga data e dorëheqjes ose e ndërprerjes, duke parashtruar arsyet përkatëse të lidhura me dorëheqjen ose ndërprerjen e marrëdhënies;

e) të trajtojnë çdo kërkesë tjetër të autoriteteve përgjegjëse dhe/ose çdo autoriteti tjetër shtetëror, në përputhje me këtë ligj.

2. Çdo komunikim i ndërsjellë ndërmjet sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive DT dhe autoriteteve përgjegjëse, në përputhje me këtë ligj, trajtohet nga në mënyrë konfidenciale nga ana e sipërmarrjeve të automatizuara të investimeve kolektive DT e ruhet si sekret profesional.

Neni 85
**Përgjegjësia e sipërmarrjeve të automatizuara të investimeve kolektive DT**

Sipërmarrja e automatizuar investimeve kolektive DT mban përgjegjësi ligjore kundrejt çdo klienti për të gjitha dëmet që janë shkaktuar si rrjedhojë drejtpërdrejt e shkeljes së kërkesave të përcaktuara në këtë ligj, aktet nënligjore dhe prospektin e plotë të sipërmarrjeve të automatizuara të investimeve kolektive DT.

KREU IX
NDALIMI I ABUZIMIT ME TREGUN

Neni 86
**Zbatimi i këtij kreu**

Ndalimet dhe kërkesat që parashikohen në këtë kre zbatohen mbi të gjitha veprimet e cilido personi juridik ose fizik, të cilat përbëjnë abuzim tregu, të përshkruara në këtë kapitull, ose të detajuar nëpërmjet akteve nënligjore të posaçme të lëshuara nga AMF-ja, në lidhje me tokenët digjitalë/ monedhat virtuale, të cilat pranohen për tregtim në një bursë DLT apo platformë shumëpalëshe/të organizuar të tregtimit, ose për të cilat është paraqitur kërkesa për t'u pranuar për tregtim në këtë bursë ose platformë.

Abuzimi i tregut përfshin:

a) manipulimin e tregut;

b) tregtim, bazuar në informacionin e privilegjuar.

SEKSIONI I
MANIPULIMI I TREGUT

Neni 87
**Dispozita të përgjithshme**

Ky kre zbatohet në lidhje me të gjitha transaksionet me tokenët digjitalë/monedhat virtuale për:

a) veprimet ose mosveprimet e kryera në Republikën e Shqipërisë në lidhje me transaksionet me tokenë digjitalë/monedha virtuale të çdo personi juridik që është themeluar, ushtron veprimtari ose është listuar brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë; dhe

b) veprimet ose mosveprimet e kryera jashtë Republikës së Shqipërisë në lidhje me transaksionet me tokenë digjitalë/monedha virtuale të cilitdo person juridik që është themeluar ose ushtron veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) veprimet që ndodhin në territorin e Republikës së Shqipërisë në lidhje me të gjithë tokenët digjitalë/monedhat virtuale, pavarësisht nëse tregtohen brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; dhe

ç) veprimet që ndodhin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në lidhje me të gjitha transaksionet me tokenë digjitalë/monedha virtuale, por që tregohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 88
**Sjellja e jashtëligjshme që krijon treg të rremë**

1. Askush nuk duhet të kryejë apo të jetë shkak për kryerjen e çdo veprimi që synon:

a) të përcjellë një informacion të rremë apo mashtrues sikur po kryhet tregtim i tokenëve digjitalë/monedhave virtuale, një bursë DLT apo platformë shumëpalëshe e tregtimit në territorin e Republikës së Shqipërisë; ose

b) të përcjellë një informacion të rremë apo mashtrues në lidhje me blerjen ose çmimin e cilitdo prej këtyre tokenëve digjitalë/monedhave virtuale.

2. Askush nuk ka të drejtë që, me anë të shitblerjes së tokenëve digjitalë/monedhave virtuale, të cilat nuk përfshijnë ndryshim të përfituesit fundor të këtyre instrumenteve, ose nëpërmjet cilitdo transaksioni apo mjeti fiktiv, të mbajë, të rrisë, të ulë ose të shkaktojë luhatje në çmimin e tregut të çfarëdo tokeni digjital/monedhe virtuale.

3. Pa cenuar zbatimin e përgjithshëm të pikës 1, të këtij neni, kryen shkelje personi, i cili:

a) zbaton, merr pjesë, përfshihet ose kryen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në çfarëdolloj transaksioni shitblerjeje të tokenëve digjitalë/monedhave virtuale, kur ky transaksion nuk sjell asnjë ndryshim të përfituesit fundor të tokenëve digjitalë/monedhave virtuale përkatëse; ose

b) paraqet ose merr masa që të paraqitet një ofertë për shitblerje të çfarëdo tokeni digjital/monedhe virtuale për një çmim të caktuar, kur ka paraqitur ose ka marrë masat që të paraqitet, ose ka dijeni se një person i lidhur me të ka paraqitur ose ka marrë masat që të paraqitet, një ofertë për shitblerje të të njëjtit token digjital/monedhë virtuale, për një çmim që në thelb është i njëjtë me çmimin e parë të përmendur.

4. Në kuptim të këtij neni, shitblerja e tokenëve digjitalë/monedhave virtuale nuk sjell ndryshim të përfituesit fundor, nëse personi, i cili ka pasur interes për tokenin digjital/monedhën virtuale përpara shitblerjes, ose personi i lidhur me të në raport me këto tokenë digjitalë/monedha virtuale, ka interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi instrumentet financiare edhe pas shitblerjes.

5. Transaksioni i shitblerjes së tokenit digjital/monedhës virtuale, i përmendur në shkronjën “a”, të pikës 3, të këtij neni, përfshin:

a) paraqitjen e një oferte për shitblerje të tokenëve digjitalë; dhe

b) paraqitjen e një ftese, pavarësisht se si është shprehur, e cila, shprehimisht apo në mënyrë të nënkuptuar, fton një person të ofrojë tokenë digjitalë/monedha virtuale për shitje apo blerje.

6. Ushtrimi i veprimtarive që përbëjnë sjellje të jashtëligjshme, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, konsiderohen vepra penale në kuptim të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 89
**Manipulimi i tregut**

1. Përbëjnë manipulim të tregut:

a) transaksionet ose urdhrat për tregtim, të cilat japin ose ka gjasa të japin sinjale të rreme ose mashtruese në lidhje me ofertën, kërkesën, ose në lidhje me çmimin e tokenëve digjitalë/monedhave virtuale, ose të cilat sigurojnë mbajtjen nëpërmjet një personi ose disa personave që veprojnë në bashkëpunim të çmimit të një ose disa prej tokenëve digjitalë/monedhave virtuale në një nivel artificial, përveçse nëse personi, i cili ka kryer transaksionin ose ka dhënë urdhrin për tregtim, vërteton se arsyet e tij për ta bërë këtë veprim janë legjitime dhe se këto transaksione ose urdhra tregtimi përputhen me praktikën e pranuar të tregut;

b) transaksionet ose urdhrat për tregtim të kryera nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiktive ose

çdo formë tjetër mashtrimi;

c) shpërndarja e informacionit përmes mediave, përfshirë internetin, ose me çfarëdolloj mjeti tjetër, i cili jep apo ka të ngjarë të japë sinjale të rreme ose mashtruese për tokenin digjital/monedhën virtuale, përfshirë shpërndarjen e thashethemeve dhe lajmeve të rreme ose keqinformuese, në rastin kur personi që ka kryer shpërndarjen ka pasur dijeni, ose duhej të kishte pasur dijeni se informacioni ka qenë i rremë ose keqinformues.

2. Për qëllime të pikës 1, shkronja "c", të këtij neni, vlerësimi mbi shpërndarjen e informacionit nga gazetari gjatë ushtrimit të detyrës, bëhen bazuar në legjislacionin në fuqi për rregullimin e profesionit të gazetarit, duke evidentuar prezencën e shpërndarjes dhe/ose fshehjes së informacionit për qëllime të përfitimeve materiale në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

3. Në veçanti, konsiderohen manipulim tregu veprimtaritë dhe sjelljet e mëposhtme:

a) veprimtaria e një personi ose disa personave, të cilët veprojnë në bashkëpunim, për të siguruar një pozitë dominuese mbi ofertën ose kërkesën për një apo disa tokenë digjitalë/monedha virtuale, me pasojë mbajtjen të pandryshueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të çmimeve të shitblerjes së tokenëve digjitalë/monedhave virtuale;

b) shitblerja e tokenëve digjitalë/monedhave virtuale në mbyllje të tregut, me pasojë keqinformimin e investitorëve, të cilët veprojnë bazuar në çmimet e mbylljes;

c) përfitimi nga përdorimi i rastësishëm ose i rregullt i mediave tradicionale apo elektronike për shprehjen e një opinioni mbi një token digjital/monedhë virtuale ose, tërthorazi, mbi emetuesin e tij, pasi është mbajtur paraprakisht një qëndrim mbi këtë token digjital/monedhë virtuale, duke përfituar më pas nga ndikimi i opinionit të shprehur mbi çmimin e këtij tokeni digjital/monedhë virtuale, pa informuar e deklaruar publikisht konfliktin e interesit.

Neni 90

**Ndalimi i manipulimit të tregut**

1. Askush nuk duhet të kryejë ose të përfshihet në kryerjen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të një numri transaksionesh me tokenë digjitalë/monedha virtuale, të cilat kanë ose mund të kenë si pasojë:

a) ngritjen e rreme;

b) uljen e rreme; apo

c) përcaktimin, mbajtjen ose stabilizimin e rremë të çmimit, ose të vëllimit të tregtimit të tokenëve digjitalë/monedhave virtuale, me qëllim, ndër të tjera, nxitjen e personave të tjerë për të blerë apo shitur këto tokenë digjitalë/monedha virtuale ose tokenë digjitalë/monedha virtuale të tjera të lidhura me to, pavarësisht nëse këta persona e kanë apo jo këtë qëllim.

2. Në kuptim të këtij neni, transaksioni në lidhje me tokenët digjitalë/monedhat virtuale përfshin:

a) paraqitjen e një oferte për shitblerjen tokenëve digjitalë/monedhave virtuale; dhe

b) paraqitjen e një ftese, pavarësisht si është shprehur, me të cilën shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar ftohet një person që të ofrojë për të shitur apo për të blerë token digjital/monedha virtuale.

3. Kryerja e veprimeve në kundërshtim me pikën 1, këtij neni, konsiderohen vepra penale në kuptim të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 91

**Detyrimi për raportim**

1. Të gjitha bursat DLT dhe platformat e tregtimit përcaktojnë dhe zbatojnë procedura dhe masa, të cilat synojnë zbulimin e parandalimin e praktikave të manipulimit të tregut.

2. Në çdo rast, bursat DLT apo platformat e tregtimit informojnë autoritetin, bazuar në informacionet, tek të cilat kanë akses mbi rastet për të cilat dyshojnë në mënyrë të arsyeshme se përbëjnë abuzim tregu.

SEKSIONI II

TREGTIMI BAZUAR NË INFORMACIONIN E PRIVILEGJUAR

Neni 92

**Konstatimi i përdorimit të paautorizuar dhe përhapjes së informacionit të privilegjuar**

1. Për qëllime të vlerësimit të prezencës ose jo të veprës penale të parashikuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, lidhur me përdorimin e paautorizuar dhe përhapjen e informacionit të privilegjuar, autoritetet përgjegjëse gjatë hetimit administrativ vlerësojnë edhe nëse informacioni i privilegjuar përfshin:

a) informacion të një natyre konkrete, i cili nuk është bërë publik dhe që ka lidhje direkte ose indirekte, për një ose disa emetues, ose për një ose disa tokenë digjitalë/monedha virtuale që, në rast se do të bëhej publik, do të kishte një efekt të rëndësishëm në çmimet e këtyre tokenëve digjitalë/monedhave virtuale, ose në çmimet e tokenëve digjitalë/monedhave virtuale të tjera të lidhura me to;

b) informacion për personat që kanë për detyrë ekzekutimin e urdhrave lidhur me tokenët digjitalë/monedhat virtuale, që nuk i kanë ekzekutuar ende e që janë të një natyre konkrete edhe lidhen direkt ose indirekt me emetuesit e një apo më shumë tokeni digjital/monedhe virtuale, të cilët nëse do të ishin bërë publikë, do të kishin efekt të rëndësishëm në çmimin e tyre apo në çmimin e tokenëve digjitalë/monedhave virtual të tjera të lidhura me to.

2. Informacioni i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, konsiderohet se është i një natyre konkrete nëse përmban rrethana, të cilat ekzistojnë ose priten të ekzistojnë ose një ngjarje, e cila ka ndodhur ose pritet të ndodhë në mënyrë të arsyeshme, dhe është mjaftueshëm specifik për të nxjerrë një konkluzion si efekt i mundshëm i këtyre rrethanave, ose për të ndikuar çmimin e tokenëve digjitalë/monedhave virtuale ose çmimin e tokenëve digjitalë/monedhave virtuale të tjera të lidhura me to.

3. Nëse informacioni i përcaktuar në pikën 1, shkronja “a”, të këtij neni, do të ishte bërë publik, do të kishte një efekt të rëndësishëm në çmimin e tokenëve digjitalë/monedhave virtuale, çfarë nënkupton informacionin që një investitor i arsyeshëm do të përdorte pjesërisht ose plotësisht në marrjen e vendimeve për të investuar.

4. Nëse nga hetimi administrativ konstatohet se është kryer një vepër penale, e parashikuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, autoriteti përgjegjës paraqet kallëzim penal pranë organeve kompetente.

Neni 93

**Verifikimi i tregtimit bazuar në informacionin e privilegjuar**

Autoritetet përgjegjëse, gjatë ushtrimit të hetimin administrativ në verifikimin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji nga subjektet e licencuara, lidhur me tregtimin bazuar në informacionin e privilegjuar, vlerësojnë ndër të tjera edhe nëse:

1. Tregtimi, bazuar në informacionin e privilegjuar, ndodh atëherë kur një person zotëron informacione të privilegjuara dhe e përdor këtë informacion duke blerë apo shitur, për llogari të vet ose për llogari të palëve të treta, direkt ose indirekt, tokenë digjitalë/monedha virtuale, me të cilat lidhet ky informacion.

2. Përdorimi i informacionit të privilegjuar, duke anuluar apo ndryshuar një urdhër, lidhet me blerjen apo shitjen e tokenëve digjitalë/monedhave virtuale, me të cilat lidhet ky informacion, dhe nëse ky urdhër është dhënë përpara se personi në fjalë të zotëronte informacionin e privilegjuar.

3. Dhënia e rekomandimit nga një person që posedon informacion të privilegjuar te një person tjetër, me qëllim që të përfshihet në tregtim, ose nxitja e një personi tjetër për t’u përfshirë në tregtim. Rekomandimi sipas kësaj pike konsiston:

a) rekomandimin mbi bazën e këtij informacioni që një person tjetër të blejë apo të shesë token digjital/monedha virtuale, me të cilat lidhet ky informacion ose nxit këta persona për të shitur apo për të blerë token digjital/monedha virtuale; ose

b) rekomandimin mbi bazën e këtij informacioni që një person tjetër të anulojë ose të amendojë një porosi në lidhje me një token digjital/monedhë virtuale, me të cilin lidhet ky informacion, ose nxit këtë person të ekzekutojë anulimin ose amendimin e porosisë.

4. Personi/subjekti që ka përdorur rekomandimin, sipas pikës 3, të këtij neni, di ose duhet të dinte që është bazuar mbi një informacion të privilegjuar.

5. Pikat 1, 2, 3 dhe 4, të këtij neni, zbatohen nga autoriteti përgjegjës gjatë hetimit administrativ ndaj të gjithë personave, të cilët zotërojnë informacion të privilegjuar si më poshtë:

a) anëtarët e këshillave administrativë apo mbikëqyrës të emëtuesit;

b) personat që zotërojnë një pjesë të rëndësishme në kapitalin e emetuesit;

c) personat që kanë akses ndaj informacionit nëpërmjet punësimit, profesionit apo detyrave të tyre; ose

ç) personat që kanë akses në informacion të privilegjuar pasi janë përfshirë në aktivitete kriminale.

Pikat 1, 2, 3 dhe 4, të këtij neni, zbatohen dhe ndaj çdo personi që zotëron informacion të privilegjuar në rrethana të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë nen, nëse personi di ose duhet ta dinte që ky informacion është i privilegjuar.

6. Në rastet kur subjekti që hetohet administrativisht është person juridik, dispozitat e këtij neni zbatohen edhe ndaj individëve që marrin pjesë në vendimmarrje lidhur me blerjen, shitjen, anulimin apo

amendimin e një urdhri për emër dhe llogari të personit juridik në fjalë.

7. Nëse nga hetimi administrativ konstatohet se është kryer një vepër penale, e parashikuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, autoriteti përgjegjës paraqet kallëzim penal pranë organeve kompetente.

Neni 94

**Sjellja legjitime**

1. Për qëllime të zbatimit të neneve 92 dhe 93, të këtij ligji, fakti që një person juridik është ose ka qenë në zotërim të informacionit të privilegjuar nuk duhet të merret si provë që ky person e ka përdorur këtë informacion dhe si rrjedhojë ka kryer tregtim bazuar në informacionin e privilegjuar në rastet kur ky person juridik:

a) ka vendosur, implementuar e mbajtur procedura dhe rregullore të brendshme që sigurojnë në mënyrë efektive që asnjë person fizik, i cili merr vendime për emër dhe llogari të tij, të blejë apo të shesë token digjital/monedha virtuale me të cilat lidhet informacioni, si dhe asnjë person fizik, i cili mund të ketë pasur ndikim mbi këtë vendim, të mos jetë në dijeni të këtij informacioni; dhe

b) nuk ka inkurajuar, rekomanduar apo nxitur ose ndikuar personin fizik, i cili, për emër dhe llogari të personit juridik, ka blerë apo shitur token digjital/ monedha virtuale me të cilat lidhet ky informacion.

2. Për qëllime të zbatimit të neneve 92 dhe 93, të këtij ligji, fakti që një person është ose ka qenë në zotërim të informacionit të privilegjuar nuk duhet të merret si provë që ky person e ka përdorur këtë informacion dhe, si rrjedhojë, ka kryer tregtim bazuar në informacionin e privilegjuar në rastet kur ky person:

a) për tokenët digjitalë/monedhat virtuale me të cilat lidhet ky informacion, është një krijues tregu ose një person i autorizuar të veprojë si kundërparti në transaksionin në fjalë dhe blerja apo shitja e këtyre tokenëve digjitalë/monedhave virtuale është kryer në mënyrë legjitime në rrjedhën normale të punës dhe funksioneve të tij si krijues tregu ose si kundërparti për këtë token digjital/monedhë virtuale, ose

b) është i autorizuar të ekzekutojë urdhra për llogari të palëve të treta, në lidhje me blerjen apo shitjen e tokenëve digjitalë/monedhave virtuale me të cilat lidhen këta urdhra, dhe është kryer në mënyrë legjitime, në rrjedhën normale të punës dhe ushtrimit të profesionit apo detyrave të tij;

c) për qëllime të zbatimit të neneve 92 dhe 93, të këtij ligji, fakti që një person është ose ka qenë në zotërim të informacionit të privilegjuar nuk duhet të merret si provë që ky person e ka përdorur këtë informacion dhe, si rrjedhojë, ka kryer tregtim bazuar në informacionin e privilegjuar në procesin e marrjes në kontroll ose shitjes së shumicës së aksioneve, në rastet kur ky person kryen transaksionin e marrjes në kontroll apo shitjes së shumicës së transaksioneve dhe kur ky transaksion është kryer, duke shkarkuar një detyrim dhe është kryer në mirëbesim dhe jo për të anashkaluar ndalimin kundrejt tregtimit bazuar në informacionin e privilegjuar dhe:

i. ky detyrim rrjedh si rezultat i një urdhri të vendosur ose një marrëveshjeje të nënshkruar përpara se personi në fjalë të zotëronte informacionin e privilegjuar; ose

ii. transaksioni është kryer në mënyrë që të përmbushë një detyrim ligjor apo rregullues, i cili ka hyrë në fuqi përpara se personi në fjalë të zotëronte informacionin e privilegjuar.

ç) për qëllime të zbatimit të neneve 92 dhe 93, të këtij ligji, fakti që një person është ose ka qenë në zotërim të informacionit të privilegjuar nuk duhet të merret si provë që ky person e ka përdorur këtë informacion dhe, si rrjedhojë, ka kryer tregtim bazuar në informacionin e privilegjuar në rastet kur ky person e ka marrë informacionin e privilegjuar gjatë një procesit të marrjes në kontroll ose shkrirjes së një shoqërie dhe përdor këtë informacion vetëm me qëllimin e ekzekutimit të marrjes në kontroll të shoqërisë së listuar ose shkrirjes, me kusht që në momentin e aprovimit të marrjes në kontroll ose shkrirjes, ose pranimit të ofertës nga aksionarët e kompanisë, çdo informacion i privilegjuar është bërë publik menjëherë ose ka pushuar së qeni informacion i privilegjuar.

3. Shkronja “ç” e pikës 2, të këtij neni nuk aplikohet kur personi blen aksionet e shoqërisë gradualisht me qëllimin e marrjes së saj nën kontroll.

4. Për qëllime të zbatimit të neneve 92 dhe 93, të këtij ligji, fakti që një person përdor njohuritë e tij duke vendosur të blejë ose të shesë token digjital/ monedha virtuale gjatë procesit të blerjes ose shitjes së tokenëve digjitalë/ monedhave virtuale nuk do të përbëjë në vetvete përdorim të informacionit të privilegjuar.

5. Pavarësisht përcaktimeve të këtij neni, një shkelje mbi ndalimin e përdorimit të informacionit të privilegjuar mund të konsiderohet se ka ndodhur në qoftë se autoriteti gjykon se arsyeja e urdhrit për të tregtuar, transaksionuar apo sjellja e personit ka qenë jolegjitime.

Neni 95
**Deklarimi i jashtëligjshëm i informacionit të privilegjuar**

1. Për qëllim të këtij ligji, deklarimi i jashtëligjshëm i informacionit të privilegjuar ndodh atëherë kur personi e zotëron informacionin e privilegjuar dhe ia tregon atë çdo personi tjetër, me përjashtim kur deklarimi bëhet gjatë ushtrimit normal të punësimit, profesionit ose detyrave të tij.

2. Për qëllimet e këtij ligji, deklarimi paraprak i rekomandimeve ose nxitësve të referuar në nenin 93, të këtij ligji, nënkupton një deklarim të paligjshëm të informacionit të privilegjuar, sipas këtij neni, dhe personi që e deklaron këtë rekomandim ose nxitës e di ose duhet ta dinte që ishte bazuar në informacion të privilegjuar.

Neni 96
**Kumbuesit e tregut**

1. Një kumbues tregu nënkupton komunikimin e informacionit përpara deklarimit të një transaksioni, në mënyrë që të nxitet interesi i investitorëve potencialë në konkludimin e një transaksioni të mundshëm dhe kushtet që lidhen me të, si madhësia potenciale ose çmimi ndaj një ose më tepër investitorëve nga:

a) një emëtues;

b) një ofertues sekondar i një tokeni digjital/monedhe virtuale, në madhësi të tillë ose vlerë që transaksioni veçohet nga urdhrat e zakonshëm të tregtimit dhe përfshin një metodë shitjeje bazuar në vlerësimin paraprak të interesave potencialë nga investitorët potencialë;

c) një palë e tretë që vepron për emër dhe llogari të një personi të referuar në shkronjat më sipër.

2. Kumbuesi i tregut vepron në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe akteve rregulluese në lidhje me ndalimin e abuzimit të tregut.

Neni 97
**Ndalimi i tregtimit bazuar në informacionin e privilegjuar dhe zbulimit të jashtëligjshëm të informacionit të privilegjuar**

Asnjë person nuk mund:

a) të kryejë ose të tentojë të kryejë tregtim të bazuar mbi informacionin e privilegjuar;

b) të rekomandojë që një person tjetër të tregtojë bazuar në informacionin e privilegjuar; ose

c) të zbulojë në mënyrë të jashtëligjshme informacionin e privilegjuar.

KREU X
LIKUIDIMI

Neni 98
**Likuidimi vullnetar**

1. Asambleja e përgjithshme e titullarit të licencës mund të vendosë për prishjen e shoqërisë apo për ndryshimin e veprimtarisë së saj vetëm pas miratimit paraprak të AMF-së.

2. Kur merret vendimi, sipas pikës 1, të këtij neni, këshilli i administrimit ose këshilli mbikëqyrës kryen kërkesën për likuidim, i cili duhet të shoqërohet me këto dokumente:

a) një kopje e vendimit të asamblesë së përgjithshme në lidhje me likuidimin e propozuar;

b) arsyet e likuidimit;

c) emrat e likuiduesve të propozuar;

ç) një raport i detajuar financiar në lidhje me trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim gjatë likuidimit, të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe një parashikim të kohëzgjatjes së procesit.

3. Brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, AMF-ja merr vendim nëse propozimet e paraqitura, në zbatim të pikës 2, të këtij neni, janë të përshtatshme, si dhe informon titullarin e licencës për miratimin ose refuzimin e kërkesës për likuidim, sipas rastit.

4. Autoriteti miraton likuidimin vullnetar, vetëm nëse gjykon se mund të paguhen të gjitha detyrimet kundrejt kreditorëve të shoqërisë.

5. Autoriteti publikon në faqen e tij të internetit vendimin e miratimit për hapjen e likuidimit vullnetar.

6. Kur autoriteti e ka miratuar procedurën e likuidimit vullnetar, mund të vendosë:

a) të kufizojë veprimtarinë e titullarit të licencës dhe ta lejojë të ndërmarrë veprimtaritë e përcaktuara ose ato veprimtari që janë të nevojshme për likuidimin vullnetar; dhe

b) të përcaktojë se deri në çfarë mase zbatohen rregullat e administrimit të riskut në shoqërinë e titullarit të licencës gjatë likuidimit vullnetar.

7. Pasuritë e klientëve të titullarit të licencës, qofshin këto para FIAT ose token digjital/monedha virtuale, mbahen në llogari ose portofola të veçantë nga llogaritë ose portofola të vetë shoqërisë në fjalë dhe nuk preken gjatë procesit të likuidimit vullnetar.

8. Të paktën 2 persona fizikë të aftë dhe të përshtatshëm për kryerjen e detyrave emërohen si likuidues, të cilët miratohen paraprakisht nga autoriteti dhe të cilët kanë përvojën dhe kualifikimet e kërkuara.

9. Likuiduesit mund të shkarkohen dhe të zëvendësohen sipas të njëjtave kushte të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

10. Likuiduesi merr të drejtat dhe detyrimet e administratorëve, që nga dita e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, likuiduesit i ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet në mënyrë solidare, në përputhje me këtë ligj, me përjashtim të rastit kur akti i emërimit parashikon që likuiduesit të veprojnë veçmas nga njëri-tjetri.

11. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë operacione të një kategorie të veçantë. Likuiduesi është objekt i mbikëqyrjes nga asambleja e përgjithshme.

12. Detyra e likuiduesve është të përmbyllin të gjitha operacionet e shoqërisë, të mbledhin huat e pambledhura, të shesin aktivet e shoqërisë dhe të paguajnë kreditorët.

13. Nëse, në bazë të të drejtave të kërkueshme të kreditorëve, likuiduesit arrijnë në përfundimin që pasuria dhe aktivet e shoqërisë janë të pamjaftueshme për shlyerjen e këtyre të drejtave, likuiduesit pezullojnë procedurën e likuidimit dhe i kërkojnë gjykatës përkatëse hapjen e procedurës së falimentit.

14. Likuiduesi harton një pasqyrë bilanci të situatës së shoqërisë pas emërimit të tij. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se 1 vit, likuiduesi harton edhe pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Pasqyra e bilancit miratohet me vendim të një të dytës së anëtarëve të asamblesë së përgjithshme.

15. Likuiduesi i fton kreditorët e shoqërisë, duke përjashtuar aksionarët, të parashtrojnë pretendimet e tyre në likuidimin vullnetar. Shoqëria publikon 2 herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj në internet.

16. Likuiduesi nuk i shpërndan aktivet e mbetura përpara përfundimit të afatit 30-ditor nga publikimi i thirrjes së dytë, drejtuar kreditorëve për ngritjen e pretendimeve të tyre.

17. Nëse një kreditor i shoqërisë, për të cilin likuiduesi ka dijeni, nuk parashtron pretendime, shuma përkatëse depozitohet në llogarinë bankare të shoqërisë. Kjo shumë nuk mund të sekuestrohet për detyrime të tjera të shoqërisë. Në përfundim të likuidimit vullnetar, këto shuma i kalohen autoritetit.

18. Nëse një detyrim nuk shlyhet dot menjëherë ose është objekt i pretendimeve të kërkueshme, aktivet mund të shpërndahen vetëm nëse kreditorit i është dhënë një garanci e përshtatshme.

19. Pas shlyerjes së detyrimeve kundrejt kreditorëve dhe anëtarëve, likuiduesi i shpërndan aktivet e mbetura në mënyrë përpjesëtimore aksionarëve.

20. Pas pagimit të detyrimeve të shoqërisë kundrejt kreditorëve dhe aksionarëve, likuiduesi i dorëzon autoritetit, brenda 12 muajve, një raport për procedurën e likuidimit dhe një propozim për shpërblimin e punës së tij.

21. Nëse AMF-ja refuzon një propozim për likuidim brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, vendimi për prishjen e shoqërisë ose për ndryshimin e veprimtarisë tregtare nuk mund të miratohet nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë. Çdo vendim që merr asambleja e përgjithshme në kundërshtim me këtë pikë është i pavlefshëm dhe nuk mund të regjistrohet pranë regjistrit tregtar.

22. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, dispozitat e legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare zbatohen lidhur me procedurat e likuidimit vullnetar të shoqërive tregtare të themeluara në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe që janë subjekte të këtij ligji. Rregullat e hollësishme që duhet të ndiqen gjatë procesit të likuidimit vullnetar përcaktohen përmes rregulloreve së AMF-së.

23. Subjektet e licencuara si “Ofrues i shërbimeve inovative” ose “Agjent TD” përjashtohen nga zbatimi i këtij neni.

Neni 99

**Likuidimi i detyruar**

1. AMF-ja mund të vendosë titullarin e licencës në proces likuidimi të detyruar në rastet kur:

a) titullari i licencës nuk është në gjendje t'i shlyejë detyrimet financiare brenda afatit; ose

b) titullari i licencës kryen ose ka kryer një veprimtari të rregulluar në shkelje të këtij ligji;

2. Gjatë likuidimit të detyruar, të gjitha kompetencat dhe detyrat e titullarit të licencës i kalojnë AMF-së, e cila emëron likuiduesin për të shndërruar në mjete monetare dhe shpërndarë pasuritë e subjektit, me qëllim ruajtjen e interesave e klientëve të titullarit të licencës, si dhe për të ruajtur pacenueshmërinë dhe stabilitetin e tregut.

3. Çelja e procedurës së likuidimit të detyrueshëm ka pasojën juridike të pezullimit të veprimtarisë së titullarit të licencës, i cili nuk mund të ndërmarrë veprimtari të reja të rregulluara, me përjashtim të atyre që kryhen në funksion të qëllimeve të parashikuara në pikën 2, të këtij neni.

4. Pasuritë e klientëve të titullarit të licencës, qofshin këto para FIAT ose token digjital/monedha virtuale, mbahen në llogari ose portofola të veçantë nga llogaritë ose portofola të vetë shoqërisë në fjalë dhe nuk preken gjatë procesit të likuidimit të detyruar.

5. AMF-ja, për të siguruar mbrojtjen e klientëve individë të titullarit të licencës, mund të kërkojë që klientët përkatës dhe pasuritë e tyre, qofshin këto në para FIAT ose token digjital/monedha virtuale, t'i transferohen një shoqërie tjetër që ushtron veprimtari të njëjtë. Në rastet kur kjo është e pamundur, titullari i licencës duhet t'i transferojë pasuritë e klientëve në mënyrë të drejtpërdrejtë te llogaritë personale bankare ose portofolat e tyre, sipas udhëzimeve të këtyre të fundit.

6. Autoriteti publikon vendimin e vendosjes së shoqërisë në likuidim të detyrueshëm në faqen e tij të internetit.

7. Likuiduesi kryen administrimin dhe shitjen e aktiveve e të pasiveve dhe shpërndarjen e shumave të arkëtuara te kreditorët.

8. Likuiduesi bashkëpunon me autoritetin dhe zbaton udhëzimet e autoritetit në lidhje me procesin e likuidimit të detyrueshëm.

9. Menjëherë pas emërimit, likuiduesi merr në kontroll shoqërinë, duke siguruar aktivët, librat dhe llogaritë e saj. Likuiduesi ka të drejtë aksesi në të gjitha aktivet, zyrat dhe librat e shoqërisë.

10. Likuiduesi bën inventar të aktivëve dhe pasurive të shoqërisë dhe harton një pasqyrë bilanci e relacion shpjegues në lidhje me zërat e bilancit brenda 30 ditëve kalendarike pas fillimit të likuidimit, të cilat i dorëzohen autoritetit, ndërsa një kopje i vihet në dispozicion publikut.

11. Likuiduesi synon arritjen e shumës maksimale nga shitja e aktivëve të shoqërisë, duke kryer këto veprime:

a) vijon ose ndërpret transaksionet financiare;

b) punëson nëpunësit, punonjësit ose këshilltarët e nevojshëm profesionalë;

c) nënshkruan akte në emër të shoqërisë dhe depoziton e ndjek kërkesëpadi në emër të tij, pasi merr miratimin paraprak të autoritetit.

12. Likuiduesi ka të drejtë të zgjidhë sa më poshtë:

a) kontratat e punësimit të shoqërisë me çdo person;

b) kontratat e shërbimit, në të cilat është palë titullari i licencës.

13. Brenda 1 muaji pas emërimit, likuiduesi vepron si më poshtë:

a) u dërgon me postë të regjistruar të gjithë aksionarëve dhe kreditorëve, në adresat e shënuara ne regjistrat e shoqërisë, një pasqyrë mbi natyrën dhe shumën e detyrimeve të pretenduara sipas regjistrave;

b) regjistron pretendimet e ngritura e të dokumentuara të kreditorëve.

14. Brenda 1 muaji pas datës së fundit të përcaktuar në njoftimin e dhënë në bazë të pikës 13, të këtij neni, për detyrimet e pretenduara, likuiduesi:

a) përcakton shumën, nëse ka, që titullari i licencës i detyrohet secilit kreditor të ditur;

b) përgatit për regjistrim pranë autoritetit një strukturë të detyrimeve të pretenduara.

15. Çdo kreditor ose aksionar, që përfaqëson të paktën 10 % të aksioneve të emetuara, ka të drejtën të paraqesë kundërshtim në lidhje me regjistrimin e detyrimeve të pashlyera pranë autoritetit brenda 20 ditëve pas regjistrimit të strukturës së detyrimeve të pretenduara, në përputhje me pikën 14, të këtij neni.

16. Autoriteti merr vendim për pranimin ose refuzimin e kundërshtimit, brenda 1 muaji nga data e regjistrimit të pretendimit.

17. Nëse kundërshtimi i parashikuar në pikën 15, të këtij neni, pranohet, likuiduesi ndryshon dhe përmirëson përkatësisht strukturën e detyrimeve të pretenduara ose masat e propozuara për shlyerjen e detyrimeve.

18. Likuiduesi i raporton autoritetit çdo muaj mbi ecurinë e procesit të likuidimit. Këto raporte përmbajnë informacione për shumën totale të pasiveve të kërkuara, shumën totale të aktiveve të shitura të shoqërisë dhe të shumës së të ardhurave të pritura nga shitja e aktiveve.

19. Likuiduesi i paraqet një raport përfundimtar autoritetit pas mbylljes së procesit të likuidimit.

20. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, dispozitat e legjislacionit në fuqi për tregtarët

dhe shoqëritë tregtare zbatohen lidhur me procedurat e likuidimit të detyrueshëm të shoqërive tregtare të themeluara në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe që janë subjekte të këtij ligji. Rregullat e hollësishme të likuidimit të detyruar dhe veprimtarisë së likuiduesit përcaktohen përmes rregullores së AMF-së.

21. Subjektet e licencuara si "Ofrues i shërbimeve inovative" ose "Agjent TD" përjashtohen nga zbatimi i këtij neni.

Neni 100
**Rendi i përmbushjes së pretendimeve**

1. Likuiduesi shpërndan aktivet e shoqërisë, duke shlyer detyrimet ndaj kreditorëve dhe aksionarëve, sipas këtij rendi:

a) çdo kreditor i mbuluar me garanci kolaterali, i cili nuk mund të përdorë pasurinë me të cilën është garantuar detyrimi i tij, për shkak të kufizimeve të përcaktuara me këtë ligj, deri në shumën e të ardhurave nga shitja e kolateralit;

b) shpenzimet e likuiduesit dhe autoritetit të konstatuara në funksion të likuidimit të detyrueshëm;

c) pagat e punonjësve të shoqërisë, të mbajtur në punë nga likuiduesi, për ta asistuar në likuidimin e rregullt të sipërmarrjes;

ç) kreditorët e mbuluar dhe të pambuluar me garanci lidhur me vlerën e detyrimit, që e tejkalon vlerën e shitjes së kolateralit;

d) aksionarët e shoqërisë.

2. Kur shuma për shlyerjen e kreditorëve, me të njëjtin rend përparësie, nuk është e mjaftueshme për t'i shlyer plotësisht këta kreditorë, atëherë ato shlyhen në mënyrë proporcionale me detyrimet ndaj tyre.

3. Çdo aktiv i mbetur pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve të pretenduara shpërndahet mes aksionarëve në përpjesëtim me të drejtat dhe pjesëmarrjen e tyre në kapital.

Neni 101
**Ankimi**

1. Të gjitha detyrimet e pretenduara për dhe në lidhje me paaftësinë paguese të shoqërisë bëhen në përputhje me dispozitat e këtij kreu.

2. Të drejtën për të kundërshtuar vendimin për likuidimin e detyrueshëm dhe për të kërkuar pezullim të procedurës së likuidimit të detyrueshëm, pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 30 ditëve nga publikimi i vendimit për likuidimin e detyrueshëm dhe emërimin e likuiduesit në Fletoren Zyrtare, e kanë:

a) aksionarët, që përfaqësojnë të paktën 10 % të aksioneve të emetuara;

b) kreditorët, të cilët përbëjnë të paktën një të tretën e shumës totale të pasiveve, të pretenduar nga kreditorët e tjerë, me përjashtim të aksionarëve.

3. E drejta për të ngritur padi mund të ushtrohet vetëm nëse:

a) autoriteti ka vepruar në mënyrë arbitrare dhe me pakujdesi për vendosjen në procedurë likuidimi, sipas rrethanave faktike dhe dispozitave të këtij ligji për likuidimin e detyrueshëm të shoqërisë;

b) autoriteti, likuiduesi dhe punonjësit profesionistë të emëruar për të asistuar likuiduesit janë përgjegjës për veprimet ose mosveprimet, në shkelje të dispozitave të këtij ligji, që lidhen me kryerjen e funksioneve dhe detyrimeve në procesin e likuidimit, përfshirë rastet kur këto veprime ose mosveprime janë qëllimisht të gabuara.

4. Pavarësisht nga shqyrtimi gjyqësor, në bazë të këtij neni, procesi i likuidimit të detyrueshëm, i nisur nga autoriteti, kryhet pa kufizime deri në daljen e vendimit të gjykatës, me përjashtim të rastit kur gjykata merr një vendim pezullimi.

KREU XI
SANKSIONET DHE ANKIMI

Neni 102
**Dispozita të përgjithshme**

1. Çdo shkelje me faj e dispozitave të këtij ligji, e kryer me veprim ose mosveprim, për të cilat parashikohen masa administrative, konsiderohet shkelje administrative.

2. Gjatë vendosjes së masës administrative, autoriteti sigurohet që masa administrative të jetë:

a) efektive dhe parandaluese; dhe
b) në proporcionalitet me shkallën e pasojave, që çuan në vendosjen e masës administrative, gjobë.

3. Autoriteti përcakton masën administrative në përputhje me dispozitat e këtij ligji, duke vlerësuar natyrën e shkeljes dhe pasojat e sjella prej saj.

4. Autoriteti, gjatë vendosjes së masës administrative, zbaton parimin e njëtrajtshmërisë, sipas të cilit për shkelje të ngjashme vendos sanksione të ngjashme.

5. Vendosja e dënimit administrativ, sipas këtij ligji, nuk e ndalon organin publik për të paraqitur kallëzim penal në prokurori për vepra penale. Përfundimi i një çështjeje penale kundër subjektit nuk ndalon vendosjen për të njëjtin subjekt të një dënimi administrativ, në përputhje me këtë ligj.

Neni 103
**Sanksionet**

1. Autoriteti përgjegjës ka të drejtë të vendosë gjobë administrative në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë deri në 18.000.000 (tetëmbëdhjetë milionë) lekë ndaj subjekteve të këtij ligji nëse:

a) ushtrojnë veprimtarinë dhe aktivitetin e tyre pa u pajisur me licencat ose autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
b) nuk japin apo fshehin informacionin kur kërkohet nga autoritetet përgjegjëse në përputhje me këtë ligj;
c) shkelin dispozitat e kreut IX, të këtij ligji, për abuzimin e tregut.

2. Sanksionet vendosen për çdo shkelje, si dhe për çdo mospërputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 104
**Procedura e hetimit administrativ, njoftimi dhe ankimi**

1. Autoriteti përgjegjës, gjatë hetimit administrativ për verifikimin e shkeljeve, sipas këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë nga subjekti i licencuar në hetim administrativ informacion dhe shpjegime, si dhe të marrë materialet e dokumentacionin e nevojshëm, që kanë lidhje me hetimin administrativ, sipas këtij ligji.

2. Për qëllime të pikës 1, të këtij neni, autoriteti përgjegjës i cakton subjektit të licencuar një afat për përgjigje ndaj kërkesave të tij për informacion, për dorëzimin e dokumenteve përkatëse, si dhe për dërgimin e observacioneve dhe/ose shpjegimeve të nevojshme, sipas legjislacionit që rregullon procedurat administrative dhe këtij ligji.

3. Pas përfundimit të hetimit administrativ, autoriteti përgjegjës njofton me shkrim për vendimin e marrë subjektin e licencuar brenda 10 ditëve kalendarike nga e nesërmja e marrjes së këtij vendimi.

4. Ndaj vendimit të autoritetit përgjegjës, subjekti i licencuar ka të drejtë të ankohet në gjykatën përkatëse që shqyrton mosmarrëveshjet administrative brenda 45 ditëve nga e nesërmja e marrjes së vendimit.

5. Ankimi në gjykatë nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të autoritetit.

KREU XII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 105
**Regjimi tatimor**

Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të këtij ligji, i nënshtrohen sistemit tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 106
**Aktet nënligjore**

1. Këshilli i Ministrave miraton me vendim, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet nënligjore rregulluese që i përkasin fushës së përgjegjësisë së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) miraton, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet rregulluese që i përkasin fushës së përgjegjësisë së saj, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 107
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi më 1 shtator 2020.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 21.5.2020.

Botuar ne F.Zyrtare 136/2020
Dale nga shtypi 21.07.2020